



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

ZBËRTHIMI I PËRGJIGJES SË KOSOVËS NDAJ TË KTHYERVE NGA ZONAT E LUFTËS NË SIRI DHE IRAK



Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autorë: Skënder Perteshi, Ramadan Ilazi

Hulumtues: Shpat Balaj

Redaktuar nga: Dr. Florian Qehaja

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.



Ky projekt është mbështetur nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI). Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë ato të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të IRI-t.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

ZBËRTHIMI I PËRGJIGJES SË KOSOVËS NDAJ TË KTHYERVE NGA ZONAT E LUFTËS NË SIRI DHE IRAK

PËRMBAJTJA

RRETH AUTORËVE	5
LISTA E SHKURTESAVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. HYRJE	9
Qasja metodologjike	10
2. POLITIKAT QEVERTARE PËR RIINTEGRIMIN E LUFTËTARËVE TË HUAJ TË RIATDHESUAR DHE FAMILJEVE TË TYRE	11
3. QASJET E QEVERISË NDAJ REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT TË TË KTHYERVE	14
3.1 Qasjet ndëshkuese-restorative	15
3.2 Ndhma për riintegrim shoqëror	19
3.3 Aktorët kyç qeveritarë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në riintegrimin e të kthyerve	24
3.4 Pasqyra e institucioneve kyçe të qeverisë dhe rolet e tyre për deradikalizimin dhe mbështetjen e riintegrit social dhe ekonomik të të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak.....	27
4. PASQYRA E QASJEVE TË SHOQËRISË CIVILE NDAJ PUNËS ME TË KTHYERIT	30
5. QASJET E VENDEVE TË TJERA NË LIDHJE ME RIINTEGRIMIN E TË KTHYERVE NGA SIRIA DHE IRAKU	33
6. SHËNIME PËRMBYLLËSE DHE RRUGA PËRPARA	36
PUNIMET E CITUARA	39

RRETH AUTORËVE

Skënder Perteshi, Hulamtues

Skënderi ka diplomuar për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Kolegjin Universitar "Universum". Skënderi punon si hulamtues për QKSS-në dhe udhëheq programin e QKSS-së për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimin e tij. Skënderi është autor dhe bashkë-autor i shumë raporteve hulamtuese të lidhura me tema të sigurisë, si: kundërvënia ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; integriteti në Sektorin e Sigurisë në Kosovë, ndërtimi i komuniteteve reziliente në Kosovë;

Skënderi ka punuar edhe si bashkëpunëtor dhe konsulent i lartë për tema të lidhura me sigurinë për organizata ndërkombëtare dhe lokale si: Fondacioni i Ndihmës së Kishës Finlandeze - Helsinki, Instituti RUSI, Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), OSBE, MOONSHOT Londër dhe organizata të tjera. Interesat hulamtuese të Skënderit përfshijnë: kundërvënien ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; reformimin e sektorit të sigurisë; bashkëpunimin rajonal të sigurisë;

Ramadan Ilazi, Hulamtues i Lartë

Dani është kandidat për doktoraturë në politikë dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Dublin City University (DCU) në Irlandë. Hulamtimet e tij përqendrohen në praktikat e përditshme të shtetndërtimit të BE-së. Më parë Dani ka shërbyer si Zëvendës Ministër për Integritime Evropiane në Qeverinë e Kosovës, ku ai ishte i angazhuar, ndër të tjera, në zhvillimin e Agjendës së Reformave Evropiane (ARE), si dhe në dialogun për liberalizimin e vizave. Ai ka punuar për disa vite edhe në shoqërinë civile si një nga anëtarët themelues të Institutit të Kosovës për Paqen, Lëvizjes FOL, dhe Iniciativës për Progres (INPO). Dani zotëron një diplomë master në studimet e paqes dhe konfliktit nga University of St. Andrews, dhe së fundmi ka përfunduar Seminarin për Sigurinë Rajonale nga Qendra George C. Marshall - Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë. Një nga botimet më të fundit të Danit flet për ndikimin e populizmit në rritje në BE për perspektivën e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor, botuar me Aspen Institute Germany.

LISTA E SHKURTESAVE

KT/KEDH	Kundër terrorizmit dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm
DRPR	Divizioni për Parandalim dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës
DRPR	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në MPB
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
LH	Luftëtarë të Huaj
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Ndhmës për Trajnimin Hetimor Penal
ISIS	Shteti Islamik
BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
SKSK	Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës
KKSB	Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
SNSBPV	Strategjia Nationale për Siguri në Bashkësi dhe Plani i Veprimit 2018-2023
SKRQPR	Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2018-2022.
ZKM	Zyra e Kryeministrit
P/KEDH	Parandalimi dhe Kundërvënja ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm
LHR	Luftëtarë të Huaj të Riatdhesuar
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SPEDHRT	Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që shpie në Terrorizëm 2015-2020
SSHKTPV	Strategjia Shtetërore Kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 -2022
SHSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vlerësohet se në zonat e luftës në Siri dhe Irak kanë shkuar rreth 403 qytetarë të Kosovës, dhe në vazhden e kolapsit të 'Shtetit Islamik' qeveria e Kosovës ka qenë e gatshme t'i riadhesojë qytetarët e vet nga rajoni. Kjo paraqet një sfidë të konsiderueshme për qeverinë dhe sektorët jo-qeveritarë. Studimet ekzistuese tregojnë se krijimi i programeve që lehtësojnë dhe mbështesin riintegrimin e të kthyerve ka rëndësi thelbësore për përpjekjet e përgjithshme për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Ky raport synon të adresojë një hendek në literaturën ekzistuese në lidhje me qasjet e Kosovës në mbështetjen e rehabilitimit/deradikalizimit si dhe të riintegrimit të të kthyerve. Duke u fokusuar në infrastrukturën institucionale dhe të politikave, ky raport hedh dritë mbi rëndësinë e të pasurit një përgjigje holistike (qeveritare + joqeveritare + komuniteti), një përgjigje koherente dhe të koordinuar për t'i përmbushur nevojat e të kthyerve dhe për t'i adresuar me efektivitet sfidat për riintegrimin e tyre social dhe ekonomik, si dhe për shkëputjen ideologjike.

Ky raport konstaton se, në përgjithësi, qeveria e Kosovës dhe shoqëria civile janë përgjigjur pozitivisht ndaj nevojave të të kthyerve dhe kanë mbështetur riintegrimin e tyre, pavarësisht mangësive me shtrirjen e zbatimit të zotimeve të proklamuar ndaj të kthyerve. Pas mbërritjes në Kosovë, institucionet ofrojnë kujdes mjekësor, strehim të përkohshëm, seanca të shëndetit mendor, ndërkohë që bëhet përgatitja e tyre për riintegrim në shoqëri. Kosova ka dy qasje të përgjithshme ndaj të kthyerve: qasjen ndëshkuese-restorative dhe programet e riintegrimit shoqëror. Pas një periudhe prej 72 orësh, të kthyerit merren në pyetje nga autoritetet për të përcaktuar rolet e tyre në zonat e luftës në Siri dhe Irak, ndërsa për luftëtarët e konfirmuar të huaj merret masa e arrestit. Grupi i parë i masave trajton ata kosovarë për të cilët konstatohet se kanë kryer veprën penale të pjesëmarrjes në një konflikt të huaj, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Ndërsa në shërbimin korrektues, luftëtarëve të huaj u ofrohet qasje në programe që synojnë t'u ndihmojnë me zhvillimin e shkathtësive që rritin punësueshmërinë e tyre, përfundimin e arsimimit, si dhe trajnime dhe ligjërata që trajtojnë besimet radikale fetare.

Në të njëjtën kohë, qeveria ka krijuar një divizion të posaçëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme për të punuar ekskluzivisht në koordinimin dhe ofrimin e mbështetjes për procesin e riintegrimit të të kthyerve. Të kthyerit mbështeten me strehim, regjistrimin e fëmijëve në

shkollë, një paketë të ndihmës financiare emergjente, seanca këshillimore dhe mbështetje të vazhdueshme përmes skemës së ndihmës sociale. Raporti konstaton edhe se shumica e të kthyerve janë rikthyer me sukses në shoqëri, dhe kjo si rezultat i lidhjeve të forta të bashkësisë dhe familjes. Lidhjet familjare dhe të bashkësisë ishin thelbësore edhe për të siguruar riintegrimin efektiv të fëmijëve jetimë. Ky është një demonstrim i një kohezioni të fortë social në Kosovë, çka siguron faktorin më të rëndësishëm kur shqyrtohet riintegrimi i të kthyerve. Shënimet nga katër grupet e fokusit në katër rajone të ndryshme të Kosovës: Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Kaçanik, konfirmojnë se të gjithë qytetarët janë të hapur ndaj të kthyerve dhe nuk kanë qasje diskriminuese që do të pengonin riintegrimin e tyre. Këto zhvillime tregojnë se efektiviteti më i lartë në riintegrimin e të kthyerve arrihet kur ky proces nuk është krejtësisht i orkestruar ose menaxhuar nga qeveria, por lehtësohet nga komuniteti dhe lidhjet e forta familjare. Raporti konstaton edhe se në praktikë qeverisë i mungojnë politikat koherente dhe ka mangësi serioze me koordinimin dhe përfshirjen e shoqërisë civile në proces.

1. HYRJE

Mes viteve 2012 dhe 2018, në zonat e luftës në Siri dhe Irak shkuan shumë evropianë, dhe mes tyre edhe një numër i vlerësuar prej 403 kosovarësh, nga të cilat 255 konsiderohen luftëtarë të huaj, ndërsa pjesa tjetër janë gra dhe fëmijë (Perteshi S. , 2018). Pas kolapsit të ISIS-it, Kosova është ndër vendet e pakta që kanë shprehur gatishmërinë që t'i riadhesojnë qytetarët e vet. Përpjekjet e Kosovës bëjnë dallim nga disa vende të tjera evropiane që hezitojnë t'i riadhesojnë qytetarët e tyre, ose madje në disa raste edhe ua kanë hequr shtetësinë. Sipas deklaratave të zyrtarëve publikë, qeveria e Kosovës beson se e ka detyrim moral dhe kushtetues që t'i riadhesojë qytetarët e vet, si dhe t'u ndihmojë të riintegrohen në komunitetet që lanë pas. Sipas fjalëve të një ministri qeveritar, të kthyerit "[...] meritojnë rehabilitimin dhe të shpresojnë për një jetë të qetë [...]. Këta qytetarë tanët, veçanërisht fëmijët, kanë kaluar një periudhë të përvojave të rënda traumatike, por tani ne do të kujdesemi për ata në mënyrë që t'i kapërcejnë këto përvoja të hidhura." (Tahiri, 2019, para. 5).

Rreth 242 kosovarë janë kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Është e domosdoshme të vendoset një qasje koherente dhe e organizuar për të mbështetur rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Literatura ekzistuese mbështet idenë se programet e riintegritit kanë rëndësi thelbësore për parandalimin e 'recidivizmit', si dhe për kundërvënien ndaj radikalizimit në shoqëri (Holmer & Shtuni, 2017, p. 2). Ky raport shqyrton se si është marrë qeveria e Kosovës me të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Raporti analizon politikat qeveritare, institucionet dhe programet që janë krijuar për të lehtësuar riintegrimin e të kthyerve. Raporti trajton edhe rolin e shoqërisë civile në proces. Ky raport mbulon aktivitetet kryesore të rehabilitimit dhe riintegritit të ndërmarra nga qeveria deri në tetor të vitit 2019 bazuar në informacionin e ofruar nga zyrtarët e qeverisë përmes intervistave. Argumenti kryesor i këtij raporti është se ndërkohë që qeveria e Kosovës ka krijuar institucionet e nevojshme për menaxhimin dhe koordinimin e mbështetjes për rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve, asaj i mungojnë politikat koherente dhe ka sfida dhe mangësi të rëndësishme me koordinimin ndërqeveritar, si dhe me pjesëmarrjen e shoqëria civile në proces.

Pjesa e parë e këtij raporti siguron një përmbledhje të politikave kryesore të qeverisë në lidhje me deradikalizimin, si dhe riintegrimin e të kthyerve. Kjo pjesë tregon se ndërkohë që ka politika të miratuara nga qeveria, nuk ka qasje koherente dhe të integruar për riintegrimin e të kthyerve. Pjesa e tretë heton më në detaje programet aktuale që zbaton qeveria për të mbështetur riintegrimin shoqëror të të kthyerve. Kjo pjesë tregon se qeveria ka krijuar shërbime të dedikuara për

të kthyerit, por hasen sfida me burimet dhe koordinimin. Pjesa e katërt diskuton angazhimin e shoqërisë civile dhe potencialin e saj për të luajtur një rol më thelbësor në partneritet me qeverinë për të mbështetur riintegrimin e të kthyerve. Pjesa e pestë ofron një përmbledhje të shembujve të programeve të riintegrit nga vendet e tjera, kurse pjesa e gjashtë thekson nevojat dhe sfidat për rrugën përpara në riformulimin e qasjeve të qeverisë së Kosovës.

QASJA METODOLOGJIKE


Informacioni i paraqitur dhe analizuar në këtë raport bazohet në intervista të thelluara sy më sy me zyrtarë qeveritarë dhe nga organizatat e shoqërisë civile, grupet e fokusit dhe analizën e dokumenteve. Intervistat u kryen me zyrtarë qeveritarë nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Përveç tyre, në komuna të ndryshme u realizuan pesë grupe fokusi që kishin përbërje të larmishme të pjesëmarrësve nga institucionet publike, udhëheqës të komunitetit, studentë dhe organizatat ndërkombëtare. Janë dy limite të rëndësishëm për këtë raport që duhet të theksohen. Së pari, pavarësisht përpjekjeve tona, të intervistuarit shpesh nuk ishin të gatshëm të ndanin informacione të hollësishme në lidhje me programe, politika ose projekte të veçanta, dhe në disa raste, ata dukej se nuk e dinin shtrirjen e përfshirjes së institucionit të tyre, duke e kufizuar analizën tonë. Së dyti, ky raport nuk duhet të lexohet si një përmbledhje gjithëpërfshirëse e qasjeve të rehabilitimit dhe riintegrit të qeverisë së Kosovës. Një përmbledhje e tillë është e rëndësishme dhe duhet të porositet nga qeveria.

Gjithashtu, duhet dhënë një shënim sqarimi për termat dhe përkufizimet. Ndërkohë që nuk ka konsensus si duhet t'u referohemi individëve të riadhesuar nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, ekziston një opinion i gjerë që referencat si 'individë të radikalizuar' apo edhe 'luftëtarë të huaj' mund të çojnë në stigmatizim, marginalizim, madje shihen si terme dehumanizuese. Prandaj, përveç nëse konteksti kërkon përdorim e termit 'luftëtar i huaj', përgjithësisht ky raport do t'u referohet qytetarëve të riadhesuar nga zonat e luftës në Siri dhe Irak si 'të kthyer'. Së dyti, raporti i referohet rehabilitimit dhe riintegrit, terma këto që mund të përdoren edhe këmblyshëm, në varësi të kontekstit. Sidoqoftë, për qëllim të qartësisë, në kontekstin e këtij raporti, koncepti i rehabilitimit përdoret kryesisht për të përshkruar përpjekjet e qeverisë për të mbështetur shkëputjen e të kthyerve nga ideologjia e dhunshme dhe radikale. Riintegrimi u referohet përpjekjeve qeveritare dhe joqeveritare për t'u ndihmuar të kthyerve në sfidat e tyre sociale dhe ekonomike, në mënyrë që të lehtësohet riintegrimi i tyre në shoqëri.

2. POLITIKAT QEVERTARE PËR RIINTEGRIMIN E LUFTËTARËVE TË HUAJ TË RIATDHESUAR DHE FAMILJEVE TË TYRE

Në vitin 2015, Kosova ishte ndër vendet e para në Ballkanin Perëndimor që miratoi Ligjin për Ndalimin e Përfshirjes në Konflikte të Armatosura jashtë Territorit Shtetëror. Në lidhje me një politikë të dedikuar të qeverisë për rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve, Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që shpie në Terrorizëm (SPEDHRT 2015-2020) përmban dispozita specifike për këtë çështje. Strategjia ka katër objektiva të përgjithshëm, dhe 'Deradikalizimi dhe riintegrimi i personave të radikalizuar' është njëri prej tyre. Ky objektiv strategjik ndahet më tej në gjashtë objektiva specifike dhe 11 aktivitete. Sipas SPEDHRT 2015-2020 përpjekjet për riintegrim të qeverisë së Kosovës janë përqendruar kryesisht në "persona ose grupe që janë identifikuar në Kosovë, [...] dhe nuk kanë shkelur ligjin, sepse më pas ata u nënshtrohen ligjeve në fuqi" (Government of Kosovo, 2015, p. 24). Strategjia përkrahet, ndër të tjera, tre masa praktike për riintegrimin: ofrimin e "këshillimit psikologjik dhe fetar për të burgosurit në lidhje me aktivitetet e paligjshme të lidhura me ekstremizmin", ofrimin e "mbështetjes sociale për familjet e tyre" dhe "zhvillimin e programeve të reja të punësimit ose metodave tjera të riintegrimin të individëve të deradikalizuar në shoqëri" (po aty). Sipas një raporti për vitin 2018 të përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës pranë Zyrës së Kryeministrit, për zbatimin e Planit të Veprimit të SPEDHRT 2015-2020, objektivi i deradikalizimit dhe riintegrimin të personave të radikalizuar ka shkallën më të ulët të zbatimit krahasuar me tre objektivat e tjerë, me vetëm 36% të aktiviteteve të parapara të zbatuara. Për më tepër, raporti vëren se janë zbatuar vetëm katër nga 11 aktivitetet e planifikuara.

Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që shpie në Terrorizëm 2015-2020



Raporti vëren se qeveria ka planifikuar të zbatojë edhe disa aktivitete shtesë për riintegrimin e personave të radikalizuar, siç është ‘përfshirja e grupeve të cenueshme në tregun e punës’, dhe çka është më e rëndësishmja të identifikojë ‘shërbimet’ e reja për të mbështetur rehabilitimin dhe riintegrimin. Me qëllim të sigurimit të asistencës, Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë (SKRQPR 2018-2022), në pjesën për grupet e cenueshme përfshin një shpjegim të vogël rreth asaj që strategjia i referohet si ‘riintegrim i personave të kthyer nga zonat e konfliktit’. Strategjia përcakton së grupe të cenueshme do të thotë “personat e riatdhesuar të cilët kanë nevojë për masa të veçanta të riintegritit si pasojë e kapacitetit të tyre të zvogëluar funksional, për shkak të sëmundjes apo aftësive të kufizuara, apo si pasojë e gjendjes së tyre familjare, gjinisë, moshës, analfabetizmit apo arsyeve të ngjashme, ose personat të cilëve u mungojnë njohuritë adekuate të gjuhëve zyrtare të Kosovës” (Ministry of Internal Affairs , 2017, p. 22). Strategjia u bën thirrje institucioneve që të përgatiten dhe të plotësojnë nevojat e familjeve të personave të kthyer nga zonat e konfliktit. Në lidhje me mbështetjen konkrete, strategjia thekson si më poshtë: “Si masë për mbështetje të kësaj kategorie do të zhvillohet plani i reagimit nën udhëheqjen

e MPB-së, do të vendoset sistemi efektiv i trajtimit në kuadër të sistemit të riintegrit, dhe do të dizajnohen pakot standarde të mbështetjes, që i përshtatet nevojave specifike të tyre” (po aty, f. 23).

Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit (SSHKTPV 2018-2022) e pranon “kërcënimin nga luftëtarët e huaj terroristë për institucionet demokratike, si dhe karakterin laik të kosovarit”. Sipas strategjisë, ekstremizmi me bazë fetare është një nga kërcënimet kryesore të sigurisë për Kosovën (Ministry of Internal Affairs, 2018, p. 8) . Në lidhje me luftëtarët e huaj, strategjia shprehet se: “Rreziku kryesor me të cilin përballlet Kosova është kthimi i luftëtarëve të tillë me bindje radikale dhe me një interes për ta dëmtuar Kosovën si një shtet me shoqëri shumë-etnike dhe shumë-fetare dhe me një qeveri laike.”(po aty). SSHKTPV 2018-2022 e sheh riintegrimin e luftëtarëve të huaj si pjesë të parandalimit të përhapjes së ideologjive ekstremiste dhe radikalizimit, megjithatë nuk përmban ndonjë objektiv apo masë të veçantë në lidhje me mbështetjen sociale dhe ekonomike për riintegrim.

Për çudi, përkundër hulumtimeve bindëse që tregojnë se shpesh qasjet më të përshtatshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm përfshijnë nisma të drejtuara nga komuniteti, Strategjia Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Plani i Veprimit (SNSBPV 2018-2023) nuk përmban ndonjë dispozitë specifike për riintegrimin e të kthyerve (Ministry of Internal Affairs, 2018). Një inspektim më nga afër i dokumentit tregon se ai është shumë i dobët, dhe vështirë se plotëson standardin minimal për një dokument strategjik. Ky është një tregues, ndoshta, i mungesës së një angazhimi serioz nga ana e qeverisë në lidhje me sigurinë në bashkësi, si një sektor politikash. Ky mund të jetë rezultat i një perceptimi që siguria në bashkësi është kryesisht një përgjegjësi komunale. Strategjitë e tjera që do të kishin rëndësi për riintegrimin, siç janë Strategjia e vjetruar Shtetërore për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2013-2018, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 dhe Strategjia Sektoriale 2018-2022, nuk përmbajnë ndonjë dispozitë specifike në lidhje me riintegrimin e luftëtarëve të huaj të riatdhesuar.

3. QASJET E QEVERISË NDAJ REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT TË TË KTHYERVE

Në prill të vitit 2019 u riadhesuan 110 kosovarë nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Prej tyre, 74 ishin fëmijë, 32 gra, dhe katër luftëtarë të konfirmuar. Pas mbërritjes në Kosovë ata u pritën nga punonjësit socialë, mjekët dhe psikologët, ndërsa oficerët e policisë verifikuan shtetësinë e tyre. Katër luftëtarët e konfirmuar u arrestuan menjëherë, ndërsa pjesa tjetër e grupit “u dërgua në një qendër në Vranidoll, 10 kilometra nga kryeqyteti Prishtina, ku do të merrnin përkujdesje para se të dërgoheshin në shtëpitë e tyre në 72 orët e ardhshme.” (Bajrami & Semini, 2019) Gjatë qëndrimit në Vranidoll, të kthyerve u ishte ofruar kujdes mjekësor, i cili përfshinte edhe një psikolog që kreu një vlerësim të nevojave të tyre të shëndetit mendor. Analizat e bëra nga mjekët kosovarë tregojnë se shumica e të kthyerve shfaqin simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD), si dhe “kthim prapa dhe depresion” (Manisera, 2019). Sidoqoftë, nuk ka qartësi në lidhje me qasjet metodologjike që u ndoqën për t’i përcaktuar këto simptoma (Perteshi S., 2019). Të kthyerit nuk u morën në pyetje menjëherë nga policia ose prokurorët, në mënyrë që t’u lejohej punonjësve socialë dhe personelit mjekësor që të kryenin punën e tyre. Divizioni i krijuar posaçërisht në MPB për të koordinuar dhe menaxhuar riintegrimin e të kthyerve, ka bërë një vlerësim të nevojave të të kthyerve, si dhe ka përgatitur dokumentet personale për të kthyerit për të lehtësuar riintegrimin e tyre.

Pas periudhës prej 72 orësh të përpunimit dhe mbështetjes, u arrit në përfundimin se shumica e të kthyerve ishin në gjendje të ktheheshin në familjet e tyre. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme të theksohet se familjet si dhe komuniteti ishin shumë të gatshëm t’i mirëpresin ata sërish në mesin e tyre. Mes 74 fëmijëve që u kthyen, nëntë ishin jetimë, por edhe ata u pranuan dhe u mirëpritën nga anëtarët e fisit të prindërve të tyre. Për ata të kthyer që nuk kishin shtëpi ku të ktheheshin, në koordinim me autoritetet komunale qeveria vendosi që ata të strehohen në shtëpi me qira të marra nga qeveria për ta. MPB-ja, në koordinim me MASHT-in, vazhdoi të ofrojë mbështetje për të siguruar që fëmijët të riintegroheshin në shkolla, ndërsa në bashkëpunim me MPMS-në disa familje u përfshinë në skemën e ndihmës sociale, e cila siguroi një fond mujor financiar për ta për të mbuluar shpenzimet themelore.

Siç ilustron nga segmenti i mësipërm, qeveria e Kosovës e ka mbështetur në mënyrë aktive riatdhesimin e qytetarëve të vet nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, si dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Këto qasje mund të ndahen në dy kategori të përgjithshme: masa ndëshkuese-restorative dhe mbështetje për riintegrim shoqëror. Qasjet ndëshkuese-restorative u referohen programeve dhe aktiviteteve qeveritare, të zbatuara kryesisht në kuadër të shërbimit korrektues dhe që synojnë të mbështesin shkëputjen ideologjike të individëve të burgosur të radikalizuar, si dhe të mbështesin riintegrimin e tyre eventual në shoqëri përmes programeve arsimore që ndërtojnë shkathtësitë e tyre dhe rrisin shanset për punësim. Mbështetja për riintegrim shoqëror i referohet një sërë masash dhe shërbimesh qeveritare që lehtësojnë zhvendosjen, si dhe riintegrimin social dhe ekonomik në shoqëri të të kthyerve, përfshirë strehimin, ushqimin, fondin mujor financiar për të mbuluar shpenzimet themelore, dhe riintegrimin e fëmijëve në sistemin shkollor.

3.1 QASJET NDËSHKUESE-RESTORATIVE

Siç është shpjeguar tashmë në pjesën e mëparshme, Ligji nr. 05/L -002 për Ndalimin e Përfshirjes në Konfliktet të Armatosura jashtë Territorit Shtetëror të Republikës së Kosovës, si dhe Kodi Penal i Kosovës kanë paraparë pasoja ligjore për të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Prandaj, kërkohet një kontroll ligjor për të gjithë personat e kthyer, me qëllim që të përcaktohet nëse ata kanë kryer një vepër penale. Pjesëmarrja në konfliktin e armatosur në vendet e tjera dënohet me burgim nga 3 deri në 15 vjet, ndërsa veprimet e individëve që rekrutojnë dhe organizojnë pjesëmarrje në konflikte të huaja dënohen nga 5 deri në 15 vjet burg. Veprimet e individëve që bëjnë thirrje ose nxisin të tjerët për t'u përfshirë në konflikte të armatosura të huaja, dënohen nga 6 muaj deri në 5 vjet burg (Kosovo Assembly, 2015, pp. 1-2). Për më tepër, ligji sanksionon financimet me qëllim të rekrutimit dhe organizimit të qytetarëve të Kosovës për t'u përfshirë në konflikte të armatosura të huaja (po aty). Prandaj, nga këndvështrimi juridik, të gjithë personat e kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak janë në thelb të dyshuar, dhe për këtë arsye kërkohet që t'i nënshtrohen kontrollit ligjor për të përcaktuar nëse kanë kryer një vepër. Si pjesë e procesit të integritimit evropian, Kosova është e detyruar të sigurojë që legjislacioni i saj kombëtar të jetë në përputhje me standardet e BE-së. Prandaj, BE-ja ka monitoruar zhvillimin e legjislacionit kundër terrorizmit dhe i ka njo-hur arritjet në këtë sektor. Komisioni Evropian konsideron se "korniza ligjore e Kosovës është në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe instrumentet ndërkombëtare kundër terrorizmit"

dhe ka “legjislacionin që sanksionon fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë, në përputhje me Rezolutën 2178 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së” (European Commission, 2018, p. 31). Institucionet e Kosovës kanë arrestuar dhe ndjekur penalisht një numër të konsiderueshëm të individëve që u përfshinë në organizatat terroriste në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak ose synonin ta bënin këtë, si dhe ata që i rekrutuan, dhe shumica e këtyre rasteve përfunduan në dënime (po aty).

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) filloi të pranojë luftëtarë të huaj për herë të parë në vitin 2014, sipas zyrtarëve qeveritarë. Ndërkohë që SHKK kishte përvojë të mëparshme me individë të radikalizuar fetarë, të cilët ishin të burgosur për arsye të ndryshme, përfshirë planifikimin e sulmeve të mundshme në Kosovë, luftëtarët e huaj të riatdhesuar paraqitën një sfidë të ndryshme për sistemin. Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, SHKK nuk ishte i gatshëm, ose siç e thanë ata “ne nuk ishim plotësisht të përgatitur që t’i trajtonim, dhe nuk e kishim vetëdijen që të merreshim me ndjeshmërinë e këtij fenomeni” (Gashi S. , 2019). Një vlerësim i brendshëm i shërbimit korrektues të Kosovës u krye me mbështetjen e Programit Ndërkombëtar të Ndihmës për Trajnimin Hetimor Penal (ICITAP), një program i Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A.-ve, me qëllim të përcaktimit të qasjeve më të përshtatshme për t’u ndjekur nga SHKK-ja për trajtimin e të kthyerve. Vlerësimi konstatoi se të kthyerit e burgosur nga zona e luftës në Siri dhe Irak ishin përhapur në mbarë shërbimin korrektues, dhe për këtë arsye sugjeronte që, nëse e lejojnë kushtet, të gjithë duheshin sjellë në një vend, ose në një pavijon. Vlerësimi, ndër të tjera, propozoi edhe që SHKK-ja të zhvillojë një program të dedikuar për rehabilitimin e të kthyerve të burgosur, si dhe të zhvillojë kapacitetet e personelit të SHKK-së për të ndërtuar njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për trajtimin e të kthyerve, dhe ICITAP e ka mbështetur trajnimin e personelit të SHKK-së. Sugjerime të tjera përfshinin përmirësimin e komunikimit dhe shkëmbimin midis institucioneve kryesore të sigurisë, përfshirë policinë.

Kjo është mënyra si zhvilloi SHKK-ja një qasje të dedikuar për trajtimin e të kthyerve, e cila filloi në vitin 2016. Para kësaj qeveria nuk kishte “program gjithëpërfshirës për rehabilitimin e luftëtarëve të kthyer”. (Naddaff, 2018) Në diskursin e SHKK-së, këto qasje shpesh quhen si programe ‘rehabilitimi dhe ri-socializimi’, dhe përbëhen, ndër të tjera, nga programe arsimore që u mundësojnë atyre të përfundojnë shkollën e mesme, si dhe trajnime profesionale për t’i përgatitur për tregun e punës në fusha të tilla si zdruktartari, sistemi i furnizimit me ujë, saldimi, etj. Sipas zyrtarit të SHKK-së, të kthyerit që janë të burgosur në burgun e sigurisë së lartë kanë qasje edhe në një program për shkathtësi komunikimi. Këto përpjekje synojnë që

kolektivisht të arrijnë si deradikalizimin, ashtu edhe të mbështesin riintegrimin e të kthyerve në shoqëri dhe të parandalojnë mundësinë e rikthimit në dhunë ose angazhimit ndaj besimeve radikale fetare. Nuk është e qartë si e përcakton sistemi se kush shkon në burg me siguri të lartë apo dërgohet në qendrat e tjera të paraburgimit, përveçse duke u bazuar në kriteret e përcaktuara mirë në sistemin e drejtësisë që bazohen në madhësinë e dënimit, si dhe kërcënimin që paraqet individit për shoqërinë. Sidoqoftë, nëse qëllimi është të mbështetet deradikalizimi dhe rehabilitimi i të kthyerve të burgosur, atëherë është e rëndësishme të merret parasysh edhe se cilat struktura kanë programe të mirë-vendosura që lehtësojnë rehabilitimin e tyre. Gjithashtu, nga të dhënat e disponueshme nuk është e qartë sa të kthyer kanë marrë pjesë në programe ose sa efektive kanë qenë ato. Sipas të dhënave të QKSS-së, shumë të kthyer kanë refuzuar të marrin pjesë në këto programe. Kjo vërtetohet edhe nga dëshmi të tjera. Për shembull, Kujtim Bytyqi dhe Sam Mullins diskutojnë rastin e një LHR-je të njohur me pseudonimin 'Abu Albani', i cili nuk pranoi të bashkëpunonte me programin e deradikalizimit në burg dhe mbeti besnik ndaj besimeve radikale fetare dhe ishte 'i indinjuar ndaj qeverisë së Kosovës'. (Bytyqi & Mullins, 2019)

Sipas zyrtarëve të SHKK-së, edhe pas katër viteve të zbatimit, programi konsiderohet të jetë 'në fillimet e veta' dhe ata nuk kanë ende ndonjë storje të rëndësishme suksesi për të ndarë, por besojnë se programi po funksionon mirë. Shumica e pjesëmarrësve të këtij programi në SHKK marrin pjesë në baza vullnetare, sepse nuk është i detyrueshëm. Sidoqoftë, një nga sfidat kryesore që pengoi suksesin e programeve të rehabilitimit në SHKK, përveç burokracisë, ishte edhe planifikimi i dobët që parandaloj fillimin e hershëm të programit. Deri kur SHKK-ja e vendosi programin e rehabilitimit në vitin 2016, shumica e të kthyerve të burgosur i kishin përfunduar dënimet e tyre. Sfidat shtesë për ata që ndjekin programe është mungesa e përcjelljes pas lirit të tyre. Kjo do të thotë që të kthyerit që trajtohen jashtë SHKK-së nuk kanë një adresë institucionale që t'i ndihmojë t'i përdorin shkathësitë, siç do të ishte lidhja e tyre me kompani të përshtatshme (Gashi, 2019).

SHKK-ja nuk ka një politikë ose një mekanizëm të vendosur për të mbajtur komunikim të vazhdueshëm me familjen e një luftëtari të huaj. Sidoqoftë, kur një i kthyer i burgosur i afrohet përfundimit të dënimit, SHKK-ja i dërgon punëtorët e saj socialë që të vizitojnë familjen e tij/saj në mënyrë që të kuptojnë më mirë kushtet e jetesës, mjedisin ku do të kthehet individit, dhe të kryejë një vlerësim të përgjithshëm socio-ekonomik të situatës. Ata shqyrtojnë edhe dimensionet ideologjike dhe përpiqen të kuptojnë nëse individit përkatës është ende i përkushtuar ndaj ideologjisë radikale fetare dhe gjasat që ai/ajo të veprojë sipas atyre besimeve

meve. SHKK-ja përgatit një raport bazuar në gjetjet e tyre dhe ia dorëzon MPB-së. Sidoqoftë, përkundër kësaj, shpesh ka sfida me komunikimin. Të dhënat e SHKK-së tregojnë se në të paktën dy raste, divizioni i krijuar posaçërisht në MPB për të koordinuar riintegrimin e të kthyerve ishte informuar për lirimin e të kthyerve të burgosur vetëm përmes mediave. Zyrtarët e SHKK-së mendojnë se i kanë kapacitetet e nevojshme për t'i menaxhuar programet ekzistuese, por do të mirëprisnin trajnime shtesë për t'i avancuar shkathtësitë e tyre.

Në vitin 2018, Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) nënshkruan një marrëveshje për zbatimin e një programi të ri në SHKK që synon deradikalizimin dhe shkëputjen ideologjike të të kthyerve të burgosur (Ministry of Justice, 2018). Sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, BIK-u siguron imamë të verifikuar që realizojnë ligjëratat fetare në SHKK, ndërsa MD-ja organizon logjistikën e kryerjes së ligjëratave të tilla në objektet e SHKK-së. Qëllimi i këtij programi është rrëzimi i ideologjive radikale fetare që i frymëzuan të kthyerit të përfshihen në zonat e luftës në Siri dhe Irak. Sidoqoftë, ndërkohë që programi kishte qëllime të mira, ai u përball me dëme të pariparueshme që nga fillimi, për shkak të publicitetit të programit. Për shembull, Ministria e Drejtësisë deklaroi se imamët e BIK-ut që do të merrnin pjesë në program do të verifikoheshin nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), duke e cenuar efektivisht besueshmërinë e imamëve që përpara se ata të viheshin në punë. Sipas zyrtarëve qeveritarë, disa të kthyer të burgosur nuk i pranuan imamët që dukej se ishin në bashkëpunim me qeverinë dhe veçanërisht institucionet e sigurisë (Perteshi S. , 2019). Ndërkohë që ligjëratat u organizuan, sipas të dhënave të QKSS-së, ata për të cilët ishin menduar ligjëratat nuk morën pjesë. Gjithashtu, SHKK-ja nuk e ka parë programin me ngjyra pozitive. Siç janë shprehur zyrtarët të SHKK-së, 'politika e shkatërroi programin' (po aty).

Në përgjithësi, zyrtarët e SHKK-së të intervistuar për këtë raport pohojnë se ekzistojnë sfida serioze në lidhje me efektivitetin e qasjeve ndaj rehabilitimit të të kthyerve të burgosur. Sipas këtyre zyrtarëve, disa të kthyer të burgosur vazhdojnë të shfaqin sjellje radikale dhe refuzojnë ta pranojnë legjislacionin e Kosovës, duke respektuar vetëm ligjit të Sheriatit (Gashi S. , 2019). Një konstatim i ngjashëm mbështetet edhe nga Kujtim Bytyqi dhe Sam Mullins, të cilët argumentojnë se disa prej të kthyerve mbetën të përkushtuar ndaj ideve ekstremiste, përfshirë "përdorimin e dhunës kundër armiqve të Islamit" (Bytyqi & Mullins, 2019). Zyrtarët e SHKK-së argumentojnë se të kthyerit e burgosur paraqesin një kërcënim të vazhdueshëm për sigurinë kombëtare të Kosovës.

3.2 NDIHMA PËR RIINTEGRIM SHOQËROR

Për të kthyerit për të cilët nuk konstatohet se kanë kryer një vepër penale, ata mbështeten nga qeveria e Kosovës që të rivendosen përsëri në komunitetet e tyre. Për t'i koordinuar këto përpjekje, qeveria e Kosovës krijoi një njësi të posaçme në MPB, përkatësisht në Departamentin për Siguri Publike, të quajtur Divizioni për Parandalim dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar (DPRPR). DPRPR-ja punon në baza ditore, në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë, për riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Qasjet e DPRPR-së i japin përparësi komunitetit dhe familjes në përpjekjet e tyre, dhe gjithashtu koordinojnë me institucionet e tjera qeveritare. DPRPR-ja ka arritur të zhvillojë besim dhe partneritet të fortë me familjet e kthyer. Puna e DPRPR-së filloi në vitin 2017 kur iu drejtuan atyre që u kthyen në baza vullnetare dhe iu siguruan ndihmë dhe mbështetje emergjente. DPRPR-ja ka burime të kufizuara dhe shpesh mbështetet në përkrahjen nga donatorët dhe qasjen në burimet e një departamenti tjetër në MPB, të quajtur Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR), i cili punon kryesisht me qytetarë të Kosovës të riatdhesuar nga vendet anëtare të BE-së.

DPRPR-ja ka realizuar një numër aktivitesh për të mbështetur riintegrimin shoqëror, ku përfshihen trajnime për prindërit si të merren me fëmijët, përpjekjet për përfshirjen e familjeve në skema sociale në mënyrë që ata të marrin ndihmë mujore financiare, si dhe përpjekjet e koordinuara me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të Kosovës për t'i riintegruar fëmijët në shkolla. DPRPR ka bërë përpjekje për të vendosur koordinim të ngushtë me SHKK-në, në mënyrë që të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj sfidave për ata individë që lirohen me kusht ose e kanë përfunduar dënimin e tyre me burg, por sipas tyre këto përpjekje nuk kanë qenë shumë të suksesshme. DPRPR-ja mendon se përfshirja e SHKK-së në procesin e riintegrit shoqëror është shumë e rëndësishme. Në lidhje me bashkëpunimin në nivelin lokal, ndërkohë që komunikon me donatorët, DPRPR-ja nuk ka një mekanizëm të institucionalizuar për të siguruar koordinim dhe përfshirje koherente të komunave.

Intervistat me zyrtarë të qeverisë tregojnë se disa ministri, të tilla si Ministria e Shëndetësisë, të cilat kanë potencial të luajnë një rol të rëndësishëm në përpjekjet e qeverisë për riintegrimin e luftëtarëve të huaj të riatdhesuar, për shembull duke siguruar këshillim, nuk janë përfshirë siç duhet në proces, nuk i kanë kuptuar qartë dhe në mënyrë të definuar përgjegjësi të tyre, madje kanë pasur vështirësi në komunikimin efektiv me strukturat e vendosura të qe-

verisë së Kosovës për të koordinuar parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (Morina, 2019). Në takimin e fundit me zyrtarët nga Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, ata rikujtuan se në vitin 2017 ishin dakorduar me koordinatorin nacional të SPEDHRT 2015-2020 të bënin përgatitjen e nevojshme dhe krijuan ekupe për t'iu përgjigjur thirrjeve të mundshme për mbështetje, dhe i ndanë këto me Ministrinë e Brendshme. Sipas të njëjtëve zyrtarë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka të caktuar një koordinator, një psikiatër që është përfshirë në vlerësimin e nevojave të shëndetit mendor të të kthyerve, si dhe në mbështetjen e trajtimit të tyre. Mbështetja e qeverisë përfshin edhe "vizita në shtëpi, seanca individuale dhe familjare" (Manisera, 2019). Prej prillit 2019 të kthyerve iu siguruan të gjitha shërbimet e kujdesit shëndetësor. Gjashtë prej fëmijëve ishin të lënduar, si dhe disa gra patën ndërlikime me shëndetin e tyre. Një rast përfshinte një infeksion të mëlçisë, dhe personi nuk mund të trajtohej në Kosovë, kështu që qeveria organizoi trajtim në Turqi për një transplant të mëlçisë (Perteshi S. , 2019).

Ministria e Arsimit e Kosovës ka qenë mjaft e efektshme për riintegrimin në sistemin shkollor të fëmijëve të riatdhesuar nga zonat e luftës në Irak dhe Siri. Për shembull, fëmijët e moshës 6-7 vjeç janë regjistruar në klasë të parë, megjithatë, ka pasur raste të fëmijëve 12-13 vjeçarë që nuk e kishin mbaruar asnjë klasë, dhe ata janë regjistruar në të ashtuquajturën drejtim të të nxënies teknik, duke iu mundësuar që të fillojnë nga klasa e parë dhe të kapin nivelin e moshatarëve të tyre (Jaha, 2019). Me fjalë të tjera, kur flitet për fëmijët e riatdhesuar nga Siria dhe Iraku, ata të gjithë janë regjistruar me sukses në sistemin arsimor. Gjatë kohës së shkrimit të këtij raporti, Ministria e Arsimit po bënte përpjekje për regjistrimin e fëmijëve 3-5 vjeç në kopshte, por nuk na u tregua numri i saktë i fëmijëve. Gjithashtu, MASHT-i ka realizuar trajnime për mësuesin të shkollave për temën e ekstremizmit fetar. Disa fëmijë kanë nevojë edhe për mbështetje që të përmirësojnë të kuptuarit dhe të folurit e gjuhës shqipe (Focus-Group-Kaçanik, 2019). Sidoqoftë, vlen të përmendet se ky përparim i Ministrisë së Arsimit u referohet aspekteve teknike të regjistrimit të fëmijëve në sistemin shkollor, dhe nuk duket se adreson aspektet sociale të procesit të riintegrit të këtyre fëmijëve. Edhe zyrtarët e Ministrisë e pranuan këtë gjatë intervistave. Nuk është e qartë si janë përgjigjur fëmijët ndaj trajtimit në shkollat e tyre, përfshirë edhe ndaj programit mësimor. Për më tepër, duket se mungon një hallkë e komunikimit me prindërit e fëmijëve, në mënyrë që të kuptohet si u qasen ata gjërave që mësojnë në shkollë fëmijët e tyre dhe si ata kanë arritur të riintegrohen në komunitet, dhe zyrtarët nga Ministria e Arsimit pajtohen se kjo është diçka që duhet ta bëjnë (Jaha, 2019).

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) mban një pjesë të konsiderueshme të përgjegjësisë në emër të qeverisë së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me riintegrimin e luftëtarëve të huaj të riatdhesuar, si dhe të anëtarëve të familjeve të kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Përgjegjësitë e MPMS-së përfshijnë riintegrimin shoqëror si dhe mbështetjen e riintegrimin në tregun e punës (Aliu, 2019). Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se MPMS-ja ka programe të dedikuara për trajtimin e këtyre dy fushave prioritare, por që ajo përdor konizën ekzistuese institucionale dhe të politikave për mirëqenien sociale dhe mbështetjen e punësimit, duke i ofruar për të kthyerit nga zonat e luftës në Irak dhe Siri. Sipas MPMS-së janë 11 familje me 52 anëtarë që janë kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak dhe përfitojnë nga skema e ndihmës sociale (po aty). Sidoqoftë, MPMS-ja nuk ka treguar qartë nëse familje të tilla janë përfshirë në skemën e ndihmës sociale si pjesë e mbështetjes për riintegrim pas kthimit të tyre, apo ata kishin qenë përfitues të skemës para se të largoheshin nga Kosova (po aty).

Është gjithashtu e paqartë si iu drejtohet familjeve qeveria dhe si sigurohet përfshirja e tyre në skemën e ndihmës sociale. Për shembull, një grua e kthyer nga Siria dhe Iraku u ankua se, sipas fjalëve të saj: “edhe pse shteti na kishte thënë se do të na ndihmonte, deri më tani nuk ka pasur asnjë ndihmë në këtë drejtim. Ne jemi kthyer prej shtatë muajsh dhe ndihmën sociale e kemi marrë vetëm këtë muaj [dhjetor, 2019]” (RTK, 2019). Në lidhje me punësimin, zyrtari i MPMS-së nuk ishte në gjendje të thoshte nëse kishte ndonjë rast të suksesshëm të riintegrimin në tregun e punës të luftëtarëve të huaj të riatdhesuar që e kishin mbaruar dënimin e tyre me burg. Sipas zyrtarëve të MPMS-së ata nuk lajmërohen në zyrat e MPMS-së në komunat e tyre përkatëse, apo edhe nëse e bëjnë këtë nuk do të regjistrohen si ish luftëtarë të huaj, dhe ata nuk kanë arsye ta bëjnë këtë, pasi që nuk ka programe të dedikuara për ta. Një pjesë e problemit, sipas mendimit personal të zyrtarëve të MPMS-së, është se të kthyerit nga Siria dhe Iraku kanë tendencë të jenë veçanërisht mosbesues ndaj institucioneve publike. MPMS-ja ka infrastrukturën për të zhvilluar programe të posaçme dhe të përshtatura për të mbështetur zhvillimin e shkathtësive të luftëtarëve të huaj të riatdhesuar, përmes qendrave të tyre të aftësimin profesional, të cilat menaxhohen nga Agjencia e Punësimit.

Në lidhje me programet e bazuara në komunitet në nivelin lokal, ekzistojnë burime të kufizuara dhe komunat ndihen të injoruar nga përpjekjet e qeverisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë deradikalizimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj të riatdhesuar. Për shembull, në njërin nga grupet e fokusit të mbajtur në Mitrovicë, zyrtarët e pushtetit lokal shprehën se janë katër familje që janë kthyer nga zonat e luftës, dhe ndërkohë

që Komuna nuk ka ndonjë program apo mekanizëm të veçantë për të punuar me këto familjet dhe për të mbështetur riintegrimin e tyre, ata pretendojnë se kanë marrëveshje bashkëpunimi me psikologë dhe sociolog për të ofruar mbështetje (Focus-Group-Mitrovica, 2019). Është e paqartë nëse ata janë përdorur dhe nëse shërbimet e tyre janë pranuar nga familjet. Të kthyerit janë trajtuar kryesisht përmes skemës ekzistuese të ndihmës sociale dhe familjet me fëmijë nën moshën 18 vjeç mund të marrin rreth 100 euro në muaj për çdo fëmijë. Qendra komunale për mirëqenie sociale konsiderohet ndër institucionet më të përshtatshme për të mbikëqyrur përpjekjet e riintegrit, por ata nuk kanë një program të duhur për të trajtuar familjet e kthyer, dhe personelit të tyre i mungon trajnimi i nevojshëm. Nga këndvështrimi lokal, është e rëndësishme që procesi i riintegrit të mos kthehet në proces sigurie që trajtohet nga policia ose agjencia për inteligjencë. Zyrtarët komunalë vërejtën se ka edhe raste kur familjet që kanë anëtarë të burgosur nuk mund t'i përballojnë vizitat në SHKK, kështu që komuna duhet të jetë në gjendje t'i mbulojë ato shpenzime. Ka shqetësime edhe në lidhje me çdo potencial të bërjes publike të identitetit të familjeve që kthehen nga zonat e luftës, nga frika e paragjyqimeve dhe marginalizimit të mëtejshëm të familjeve të tilla nga komuniteti.

Në përgjithësi, zyrtarët komunalë mendojnë se u mungojnë burimet e nevojshme për riintegrim. Edhe grupi i fokusit në Komunën e Gjilanit tregoi rezultate të ngjashme. Mungesa e burimeve dhe mungesa e një programi të dedikuar për të punuar në riintegrimin e luftëtarëve të huaj të riatdhesuar në nivelin komunal, i përkeqësojnë sfidat ndaj menaxhimit të një riintegrimi efektiv të familjeve të kthyer nga zonat e luftës dhe luftëtarëve të huaj të riatdhesuar (Focus-Group-Gjilan, 2019). Në Gjilan shumica e pjesëmarrësve të grupit të fokusit nuk kishin dijeni për ekzistencën e Mekanizmit Komunal të Referimit. Përkundër promovimit të fortë të Mekanizmit të Referimit, kjo strukturë mbetet kryesisht e panjohur për shumë njerëz, dhe arsytet për këtë ndoshta janë të lidhura me kompetencat e tij të kufizuara dhe mbivendosjen e perceptuar me Këshillat Komunalë të Siguri në Bashkësi (KKS). Megjithatë u promovua si model, mandati i tij mund të ishte integruar lehtësisht në kuadër të KKS-ve. Një anëtar i grupit të fokusit ndau një zhvillim në njërin prej shkollave të Gjilanit, kur një nxënës i dyshuar u tregoi shokëve se synonte të shkonte në Siri, dhe e gjithë shkolla u revoltua dhe prindërit nuk donin t'i lejonin fëmijët e tyre që të ktheheshin në shkollë. Me interes të veçantë është se ata shprehën edhe shqetësim për ndikimin e politikës, si në qasjet e qeverisë ashtu edhe të institucioneve fetare në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm.



Figura 1: Qasja e përmblodhur dhe e thjeshtuar e mënyrës si merret Kosova me luftëtarë të huaj dhe qytetarë të tjerë të riatdhesuar nga zonat e luftës në Siri dhe Irak.

3.3 AKTORËT KYÇ QEVERTARË DHE NDËRKOMBËTARË TË PËRFSHIRË NË RIINTEGRIMIN E TË KTHYERVE

Qeveria e Kosovës ka krijuar pozitën e Koordinatorit Nacional në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për të mbikëqyrur zbatimin e politikës së qeverisë për kundër terrorizmin dhe kundër terrorizmit dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm (KT/KEDH). Koordinatori Nacional për KT/KEDH koordinon të gjitha aktivitetet në lidhje me parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, dhe për këtë arsye ai luan një rol të rëndësishëm në procesin e riadhesimit të qytetarëve të Kosovës nga zonat e luftës në Siri dhe Irak dhe riintegrimin të tyre. Sidoqoftë, kur flitet për aspektet procedurale dhe praktike, procesi aktual i riadhesimit të qytetarëve nga kampet në Siri koordinohet kryesisht nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Drejtësisë (MD), Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës (SKSK) pranë Zyrës së Kryeministrit, ndër të tjerë. Ekziston edhe një Grup Punues Teknik qeveritar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që bashkon aktorë qeveritarë dhe jo-qeveritarë për të lehtësuar komunikimin dhe koordinimin. Edhe Departamenti i Sigurisë Publike i MPB-së është i përfshirë nga afër në procesin e riadhesimit dhe riintegrimin. MD-ja është përgjegjëse për procedurat e përgjithshme ligjore për procesin e riadhesimit. Të gjitha riadhesimet e organizuara të qytetarëve të Kosovës janë koordinuar ngushtë dhe mbështetur nga SH.B.A. Riatdhesimi i prillit 2019 i 110 qytetarëve u koordinua nga një grup koordinues qeveritar ad-hoc të krijuar për të menaxhuar procesin specifik të riadhesimit. Në një konferencë për shtyp ku u njoftuan rezultatet e operacionit, Ministri i Drejtësisë falënderoi Shtetet e Bashkuara për mbështetjen dhe deklaroi se:

“realizimi i këtij operacioni, për të cilin ne jemi shumë mirënjohës ndaj partnerëve tanë dhe mekanizmave të sigurisë në vend, dërgon një mesazh të qartë se shteti ynë nuk do t’i braktisë qytetarët e vet, pa marrë parasysh përvojën e tyre. Përveç kësaj, kjo dërgon një mesazh të qartë se ekstremizmi i dhunshëm, radikalizmi dhe terrorizmi nuk kanë asnjë lidhje me ne, as me traditën tonë dhe realitetin në të cilin bëjmë pjesë, as me vizionin tonë shtetëror dhe shoqëror, dhe si të tillë, do të luftohen në çdo hap” (Tahiri, 2019).

Sa u përket qasjeve qeveritare të programeve të deradikalizimit dhe rehabilitimit për të kthyerit e burgosur, siç u shpjegua tashmë aktorët kryesorë përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës. Në lidhje me riintegrimin, siç u tha tashmë, ekzistojnë disa institucione qeveritare që ndajnë përgjegjësi, por aktori kryesor që punon çdo ditë për procesin e riintegrimin është Divizioni për Parandalim dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar, i cili është pjesë e De-

partamentit për Siguri Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Udhëheqësja e Divizionit, znj. Ganimete Gërbovci, e intervistuar për këtë hulumtim, shpjegoi se qasja e tyre për riintegrim përqendrohet në përfshirjen e komunitetit dhe familjes në proces (Gërbovci, 2019). DPRPR-ja ka bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) të MPB-së. Shërbimet e këtij Departamenti janë përqendruar kryesisht në shtetas të riatdhesuar nga shtetet anëtare të BE-së, kërkesat për azil të të cilëve janë refuzuar.

DRPR-ja zbaton Rregulloren e Qeverisë nr. 13/2017 për riintegrimin e personave të riatdhesuar (Government of Kosovo, 2017). Ndërkohë që kjo rregullore nuk u hartua duke pasur parasysh riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, ajo jep përkufizimet e mëposhtme të dy koncepteve kyçe me të cilat merret kjo analizë: "Personi i riatdhesuar - nënkupton një kosovar i cili, për shkak të mungesës së bazës ligjore për të qëndruar në një vend të huaj, është i ri-pranuar në Kosovë, pa marrë parasysh mënyrën e riatdhesimit të tij" ndërsa "Riintegrimi - nënkupton ri-përfshirjen e personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës dhe promovimin e kushteve të tyre ekonomike, sociale dhe politike" (po aty f. 2). Rregullorja specifikon llojet e ndihmës që ofron qeveria për personat e riatdhesuar, përfshirë ndihmën pas mbërritjes dhe përfitimet emergjente, siç janë strehimi i përkohshëm ose ndihma me qira, si dhe mbështetja për riintegrim të qëndrueshëm, e cila përfshin aftësimin profesional, përfshirjen e fëmijëve në sistemin arsimor, etj. DRPR-ja menaxhon burime financiare për t'i siguruar këto shërbime, dhe DPRPR-ja varet nga qasja në ato burime për të siguruar mbështetje të ngjashme në procesin e riintegrit të luftëtarëve të huaj. Por është e qartë se marrë parasysh numrin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre që janë riatdhesuar dhe pritet të riatdhesohen në Kosovë, miratimi i një rregulloreje të ngjashme qeveritare mund të sigurojë burime si dhe qartësi të politikave.

Një grup tjetër i aktorëve të rëndësishëm përfshin koordinatorët për SPEDHRT 2015-2020 që janë emëruar në të gjitha ministrinë qeveritare. Për shembull, Ministria e Arsimit ka një koordinator të caktuar për SPEDHRT 2015-2020, i cili menaxhon një ekip me 13 zyrtarë që vijnë nga departamente dhe sektorë të ndryshëm të Ministrisë dhe janë përgjegjës për të mbuluar masat e riintegrit nga portofoli i tyre. Sidoqoftë, kur u intervistuan për këtë raport, këta koordinatorë tregojnë se ndërkohë që atyre u është caktuar pozita përkatëse dhe kanë marrë disa trajnime, ata nuk janë të specializuara për temën, në lidhje me ekstremizmin fetar ose riintegrimin e luftëtarëve të huaj të riatdhesuar (Jaha, 2019).

Në nivelin lokal ka disa institucione relevante që merren në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me çështjet e kundërvënies dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, por nuk ka qasje koherente për çështjen e riintegrit të të kthyerve. Përveç Këshillave Komunalë për Siguri në Bash-

kësi (KKSB) që bashkojnë aktorët kyç të sigurisë dhe adresojnë shqetësimet e komunitetit, siç u diskutua më herët ekziston edhe një Mekanizëm Referimi që është themeluar si pjesë e Planit të Veprimit të SPEDHRT 2015-2020. Për shembull, në Komunën e Gjilanit, mekanizmi është themeluar në vitin 2016 dhe përbëhet nga aktorë të ndryshëm lokalë, përfshirë: psikologë, mësime, policimi në komunitet, këshilltarë juridikë, etj. Ky mekanizëm punon për zbulimin e hershëm të ekstremizmit të dhunshëm. Në vitin 2017 Mekanizmi i Referimit në Gjilan raportoi se i ishin referuar tetë raste të ekstremizmit të dhunshëm (Kika, 2017). Por ky mekanizëm nuk merret me riintegrimin e luftëtarëve të huaj të riadhesuar dhe qytetarëve të kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Edhe drejtuesit e këtij mekanizmi shprehën se nuk kanë informacione rreth përpjekjeve për riintegrim (Hyseni, 2019).

Anëtarët e Mekanizmit të Referimit do të preferonin që t'u jepej mandati i nevojshëm për t'i koordinuar edhe përpjekjet e riintegrimin, në mënyrë që të adresojnë hendekun serioz në kornizën ekzistuese institucionale. Disa komuna kanë treguar vetë-iniciativë, duke u përpjekur të formulojnë politikat e tyre në lidhje me P/KEDH. Për shembull, në vitin 2017 Komuna e Mitrovicës së Jugut, në bashkëpunim me organizatën lokale të shoqërisë civile Community Building Mitrovica (CBM), hartoi një strategji komunale për kundërvënien dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm midis të rinjve (South Mitrovica, 2017). Kjo shënon herën e parë që një komunë e Kosovës ka hartuar një politikë të tillë, por ajo ende nuk është aprovuar dhe nuk përmban masa në lidhje me riintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe individëve të radikalizuar.

Në lidhje me aktorët ndërkombëtarë të përfshirë në procesin e riintegrimin. UNDP-ja ka ofruar mbështetje për krijimin e Mekanizmave të Referimit në komunat e Kosovës, duke filluar me projektin pilot në Gjilan. Por, ky proces e ka injoruar kryesisht shoqërinë civile në këtë proces. Instituti Ndërkombëtar për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit në bashkëpunim me ICITAP dhe SH.B.A., ofruan mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve, për shembull duke sponsorizuar një punëtor tre ditore mbi rolin e psikologëve dhe udhëheqësve fetarë në rehabilitimin dhe riintegrimin në Kosovë, në vitin 2017. Misioni i OSBE-së në Kosovë "filloi të zhvillojë" bazën e të dhënave "EDHRT" (EDHRT: Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi që shpie në Terrorizëm), e cila duhej të përfshinte një bazë të dhënash të palëve të interesit qeveritare dhe joqeveritare për P/KEDH. Sidoqoftë, kjo përpjekje, e cila kishte për qëllim të mbështeste Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës (SKSK) të Zyrës së Kryeministrit për përcjelljen dhe koordinimin e aktiviteteve të lidhura me EDHRT të të gjitha palëve të interesit, partnerëve dhe organizatave mbështetëse, ka ngecur tashmë. Krijimi i bazës së të dhënave kishte për qëllim t'i ndihmonte SKSK-së në shmangien e duplikimeve dhe përsëritjeve të mundshme të aktiviteteve, si dhe t'i mundësonte prodhimin e raporteve periodike më cilësore mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e EDHRT.

3.4 PASQYRA E INSTITUCIONEVE KYÇE TË QEVERISË DHE ROLET E TYRE PËR DERADIKALIZIMIN DHE MBËSHTËTJEN E RIINTEGRIMIT SOCIAL DHE EKONOMIK TË TË KTHYERVE NGA ZONAT E LUFTËS NË SIRI DHE IRAK

Shënim: Kjo tabelë u referohet vetëm institucioneve qeveritare që merren posaçërisht me përpjekjet e deradikalizimit dhe riintegritit të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Nr.	Institucioni	Çka bëjnë?	Me çfarë sfidash përballen?	Çka mendojnë ata për përpjekjet e riintegritit?
1	<i>Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) / Departamenti për Siguri Publike /</i> Divizioni për Parandalim dhe Riintegritim e Personave të Radikalizuar (DPRPR)	Procesi i riintegritit është puna e tyre e përditshme. Ata kanë zhvilluar partneritete të ngushta me familjet dhe gëzojnë besimin e tyre. Ata ofrojnë ndihmë emergjente, koordinojnë me institucionet e tjera qeveritare për të siguruar riintegritim e fëmijëve në sistemin shkollor, dhe bëjnë përpjekje për t'i përfshirë të kthyerit në skemën e ndihmës sociale në mënyrë që ata të marrin një përfitim mujor.	<ul style="list-style-type: none"> Sfida kryesore është se ky divizion nuk funksionon në bazë të një politike të veçantë, siç është rasti i MPB/DRPR që zbaton një rregullore qeveritare që i përshkruan qartë shërbimet dhe politikat e qeverisë në lidhje me riintegritim e qytetarëve; DPRPR-ja është e kufizuar në burime dhe mungesë buxheti. Divizioni mbështetet në përkrahjen e jashtme, si dhe në përdorimin e burimeve nga departamentet e tjera në Ministri; Koordinimi me institucionet e tjera dhe shoqërinë civile. 	Familja është faktori kryesor për riintegritim efektiv. Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet të përfshihet më aktivisht në procesin e përpjekjeve të riintegritit pas burgosjes.

2	<p>Ministria e Drejtësisë /</p> <p>Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ofron programe rehabilitimi dhe ri-socializimi për të burgosurit. Pjesëmarrja është në baza vullnetare, nuk ka kërkesa specifike që të burgosurit të marrin pjesë. Këto programe përfshijnë kurse për zhvillimin e shkathtësive, të tilla si zdrukhtari, por edhe fusha të tjera siç është komunikimi. • Për më tepër, SHKK-ja ofron qasje në imamët e verifikuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, të cilët organizojnë leksione për të burgosurit për të adresuar bazën ideologjike të luftëtarëve të huaj të burgosur. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e një programi për të mbajtur angazhimin e vazhdueshëm me të kthyerit pas lirisë së tyre; • Mungesa e burimeve për të zhvilluar programe të reja; • Mungesa e akreditimit dobëson përfitimet dhe atraktivitetin e kurseve për të burgosurit; • Mungesa e angazhimit me familjet e të burgosurve. 	<p>Zyrtarët qeveritarë be-sojnë se luftëtarët e huaj të burgosur mbeten një shqetësim i sigurisë. Ndërkohë që disa kanë treguar shenja të ri-socializimit me të tjerët përmes programit të SHKK-së, ka ende nga ata që mbeten të përkushtuar ndaj ideologjive që i shtynë në veprimet e tyre për të shkuar në Siri dhe Irak në radhë të parë. Këta individë janë besnikë ndaj ligjit të Sheriatit.</p>
3	<p>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) /</p> <p>Ekipi teknik për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekzistojnë dy fusha kyçe të përgjegjësisë nën MPMS-në: mbështetja e riintegrit social dhe punësimit. Disa familje që janë kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak janë përfshirë në skemën e ndihmës sociale dhe duhet të marrin një fond prej rreth 100 eurosh në muaj. Sidoqoftë, jo të gjithë po përfitojnë nga kjo masë. DPRPR-ja koordinon me MPMS-në për këtë çështje. Sa i përket punësimit, zyrat e punësimit të Agjencisë së Punësimit janë në dispozicion për të kthyerit që të aplikojnë. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë stimulim ose politikë të veçantë për ta, ata trajtohen si qytetarët e tjerë, dhe nuk ka shumë të ngjarë që një individ që aplikon për punësim në Agjencinë e Punësimit ta prezantojë veten si një i kthyer nga Siria dhe Iraku. • Qendrat Komunale për Mirëqenie Sociale, zakonisht caktojnë menaxherë të rastit kur një familje kërkon ndihmë në procesin e riintegrit, për shembull për të mbështetur regjistrimin e fëmijëve në sistemin shkollor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Sfidë madhore është se MPMS-ja nuk duket se ka politika specifike që janë të dedikuara për të kthyerit nga zona e luftës në Siri dhe Irak, por thjesht përdor kornizën ekzistuese institucionale dhe të politikave për t'i përfshirë edhe ata. Ndërkohë që kjo po funksionon në një farë mase, të kthyerit përbalen me sfida të veçanta në përpjekjet e tyre për t'u riintegruar në shoqëri, dhe MPMS-ja duhet ta marrë parasysht këtë; • Koordinim jo adekuat, veçanërisht me nivelin komunal; • Mungesa e referimit të rasteve në zyrat e punës, në mënyrë që të kthyerit, pas kalimit të shqyrtimit gjyqësor ose pasi t'i kenë vuajtur dënimet e tyre, të mund të marrin shërbime që u ndihmojnë të gjejnë punë 	<p>Nëse të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak nuk trajtohen siç duhet, ata kanë potencialin që të kthehen në një kërcënim serioz të sigurisë. Sfidat madhore nuk janë vetëm ato sociale dhe ekonomike, por edhe problemet ideologjike dhe psikologjike, t'i cilat duhet të adresohen nga Bashkësia Islame e Kosovës</p>

4	Ministria e Shëndetësisë (MSH)	<ul style="list-style-type: none"> • Ka krijuar një grup mjekësh që të jenë në dispozicion të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të trajtuar të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak nëse është e nevojshme; • Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka caktuar një koordinator për trajtimin e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, i cili është psikolog. 	Mungesa e kapaciteteve të specializuara në institucionet publike të kujdesit shëndetësor si të merren me të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak.	Adresimi i ankesave ekonomike të të kthyerve është thelbësor për riintegrimin
5	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) / Ekipi teknik për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm	<ul style="list-style-type: none"> • MASHT ka krijuar një ekip prej 13 zyrtarësh për të koordinuar zbatimin e përgjegjësiave që ndër të tjera kanë të bëjnë edhe me riintegrimin e të kthyerve. • Roli kryesor i MASHT-it në kuadrin e riintegrit shoqëror ka qenë në mbështetjen e regjistrimit të fëmijëve të kthyer në sistemin shkollor. MASHT-i e ka bërë këtë në bashkëpunim të ngushtë me MPB-në. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nga të dhënat e disponueshme, duket se deri më sot qasjet e MASHT-it kanë qenë të suksesshme në kthimin e fëmijëve në shkollë, por nuk është e qartë si ka qenë pritja e fëmijëve dhe angazhimi i tyre me moshatarët e tyre dhe materialin shkollor. Prandaj, zyrtarët e MASHT-it e shohin këtë mungesë të politikës për mbështetjen e vazhdueshme të fëmijëve për të siguruar që ata nuk janë të marginalizuar për shkak të perceptimeve; • Mungesa e trajnimeve të specializuara për trajtimin e riintegrit të të kthyerve; • Nevoja për angazhim me prindërit e fëmijëve të kthyer dhe për përgjigje edhe nevojave të tyre arsimore. 	Sektori i arsimit duhet të përdoret më shumë sesa vetëm për regjistrimin e fëmijëve të kthyer në sistemin shkollor.

4. PASQYRA E QASJEVE TË SHOQËRISË CIVILE NDAJ PUNËS ME TË KTHYERIT

Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kanë një angazhim të kufizuar në lidhje me mbështetjen aktive dhe të drejtpërdrejtë të riintegrit të të kthyerve. Mungon një partneritet konstruktiv mes qeverisë dhe organizatave joqeveritare, çka përfaqëson një mundësi të humbur, pasi organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e riintegrit efektiv të të kthyerve. Një fushë, për shembull, ku partneriteti midis qeverisë dhe shoqërisë civile mund të jetë shumë i dobishëm, është sigurimi i një politike përgjegjëse gjinore. Një raport i UNDP-së konstaton se “shpesh, gratë dhe fëmijët e lidhur me grupe ekstremiste të dhunshme janë të padukshëm në sytë e politikës dhe ligjit ndërkombëtar” (UNDP, 2019, p. 9). Një fushë tjetër ku organizatat e shoqërisë civile në Kosovë mund të jenë shumë të dobishme, është angazhimi me të kthyerit, veçanërisht të rinjtë, për çka OJQ-të vendore kanë përvojë shumë të mirë. Në lidhje me mënyrën si bëhet kjo, hapi i parë dhe më i rëndësishëm është përfshirja dhe koordinimi. Një raport i OSBE-së vëren se: “Ekzistojnë një numër hapash praktikë që mund të ndihmojnë në mbështetjen dhe avancimin e përpjekjeve të aktorëve qeveritarë për zhvillimin e marrëdhënieve produktive dhe jo të instrumentalizuara me organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Ato përfshijnë krijimin e mekanizmave fleksibël të bashkërendimit me shumë agjenci dhe kodifikimin e partneriteteve midis aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë” (OSCE, 2018, p. 10). Në rastin e Kosovës, shumica e OJQ-ve që punojnë për çështje që i përkasin ekstremizmit të dhunshëm, janë të fokusuar kryesisht në avokim dhe mbikëqyrje të qasjeve të qeverisë, dhe ato nuk përfshihen drejtpërdrejt në përpjekjet e riintegrit të të kthyerve, megjithëse ka disa përjashtime. Prandaj, ekziston një rrugë që mund të hulumtohet më tej për të krijuar partneritet konstruktiv midis organizatave joqeveritare dhe institucioneve qeveritare në trajtimin e sfidave kryesore që dalin nga procesi i riintegrit shoqëror.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është qendra kryesore studimore për çështje që lidhen me sigurinë në Kosovë, përfshirë parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH). Prej nëntorit të vitit 2019, QKSS-ja është duke zbatuar projektin me titull “Rinia për Rininë - rritja e qëndrueshmërisë për grupet e marginalizuara në Kosovë”, duke u fokusuar në rehabilitimin dhe ri-socializimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit

në Siri dhe Irak. Qëllimi i këtij projekti është të lehtësojë procesin e riintegrit të fëmijëve të kthyer me anë të qasjeve adekuate arsimore. Ky projekt synon që të mos t'i kufizojë aktivitetet e veta vetëm me të kthyerit nga konfliktet, por ka targetuar fëmijë të tjerë të cenueshëm, siç janë ata që kanë braktisur shkollën. Braktisja dihet se ka një ndikim negativ në mundësitë e ardhshme të fëmijëve. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse shmang stigmatizimin dhe arrin një publik më të gjerë brenda vendit. Fëmijët që kthehen dihet se mbeten të izoluar dhe të marginalizuar, çka mund të pengojë ndjeshëm shkathtësitë e tyre të komunikimit ndër-personal. Përmes aktiviteteve të këtij projekti, p.sh. kampe të fundjavës, këta fëmijë mund t'i përmirësojnë këto shkathtësi dhe të rrisin tolerancën e tyre sociale. Projekti do të implementohet në Prishtinë, Viti, Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjilan, Podujevë, Prizren, Mitrovicë, Klinë, dhe komuna të tjera që kanë individë të kthyer nga konfliktet në Siri dhe Irak. Projekti mbështetet nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është një organizatë i mirënjohur joqeveritare (OJQ) e cila ofron mbështetje për trajtim dhe rehabilitim për viktimat e torturave në Kosovë (KRCT, n.d.). Në vitin 2019, QKRMT-ja u mbështet nga Ambasada e SHBA në Kosovë për të ofruar mbështetje për riintegrim për të kthyerit, me një fokus të veçantë tek fëmijët, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve publike, veçanërisht institucioneve të kujdesit parësor, që shpesh shërbejnë si kontakti i parë për të kthyerit, në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i identifikojnë shenjat e traumës ose radikalizimit në një fazë të hershme. Projekti ka paraparë edhe aktivitete për ngritjen e vetëdijes, që përfshijnë zhvillimin e materialeve informuese për shkollat dhe familjet për shërbimet e kujdesit shëndetësor në dispozicion të tyre, si dhe seanca informimi për mësimdhënësit dhe edukatorët. Këto trajnime ofrohen nga profesionistë.

OJQ të tjera që po zbatojnë aktivitete të P/KEDH dhe kanë potencial për të luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e drejtpërdrejtë të riintegrit shoqëror përfshijnë, ndër të tjera CBM, Partners Kosovo dhe FCI. Community Building Mitrovica (CBM) është një nga OJQ-të më të besueshme lokale që punon në aktivitete të lidhura me ndërtimin e paqes. Në lidhje me P/KEDH, ata po udhëheqin një konsorcium të organizatave, të përbërë nga Open Data Kosova (ODK) dhe Mundësia, në kuadër të projektit "Ndërtimi i komuniteteve të forta dhe të qëndrueshme në Mitrovicë", i financuar nga Fondi Global i Angazhimit dhe Reziliencës së Komunitetit (GCERF). Konteksti i veçantë i Mitrovicës si një qytet i ndarë, i ka shtuar sfidat me të cilat përballen komunitetet. Sipas dokumentit të projektit, qëllimi i konsorciumit është të zbatojë një qasje nga poshtë për të ndikuar drejtpërdrejt në grupin më të cenueshëm të

popullsisë - të rinjtë midis moshave 15 dhe 25 vjeç - duke krijuar një rrjet shembujsh pozitivë (agjentë të ndryshimit). Përmes programeve të zhvillimit të të rinjve që targetojnë grupet më të cënueshme të popullsisë, konsorciumi synon të krijojë një mjedis më motivues dhe angazhues për rininë, përmes programeve pozitive të zhvillimit të rinisë, trajnimeve profesionale, programeve të punësimit, eventeve kulturore dhe mundësive për të rritur reziliencën e të rinjve dhe për të zvogëluar cënueshmërinë ndaj agjendave të ekstremistëve të dhunshëm. Si pjesë e projektit, CBM e mbështeti Komunën e Mitrovicës së Jugut për të hartuar një strategji komunale për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm tek të rinjtë, duke shënuar herën e parë që një komunë zhvilloi një strategji të tillë (Municipality of Mitrovica South, 2019).

Fondi Global i Angazhimit dhe Reziliencës së Komunitetit (GCERF) Mekanizmi i Mbështetjes së Vendit i Kosovës (CSM) mbështet ose ka mbështetur një numër të OJQ-ve të tjera për të punuar në projekte të KT/KEDH, përfshirë S'Bunker, Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) - BRICK 'Ndërtimi i Qëndrueshmërisë të Individët dhe Komunitetet në Kosovë', Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) - 'Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim'. Sidoqoftë, në realitet shumica e projekteve nga OJQ-të kosovare janë shumë të përqendruara në P/KEDH, dhe bazuar në të dhënat e disponueshme, OJQ-të nuk janë përfshirë drejtpërdrejt në riintegrimin e të kthyerve. Organizatat e shoqërisë civile e theksojnë si sfidë mungesën e një qasjeje dhe koordinimi koherent midis institucioneve, si dhe ankohen se institucionet e qeverisë qendrore i injorojnë. Sipas zyrtarëve lokalë për shembull: "Nuk ka koordinim të mirë midis komunitetit dhe institucioneve arsimore dhe shëndetësore në nivelin komunal. Koordinatori Nacional nuk përgjigjet kurrë në pyetjet tona dhe kur ne kërkojmë ndihmë, ai na neglizhon." (Focus-Group-Mitrovica, 2019). Ky raport rekomandon që qeveria të krijojë një mekanizëm që ta përfshijë shoqërinë civile në proces, duke krijuar një organ këshillimor.

Siç u konstatua me gjetjet e këtij hulumtimi, shkaputja ideologjike e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak paraqet sfidën më të rëndë që i frenon përpjekjet për riintegrim shoqëror, si dhe përmban mundësinë e rikthimit të të kthyerve në ekstremizëm të dhunshëm. Gjithashtu, një tipar tjetër i rëndësishëm i përbashkët duket se është një pasojë e paqëllimtë e qasjeve të qeverisë që ka të bëjë me marginalizimin e mëtejshëm të të kthyerve, duke bërë që ata të ndihen të dehumanizuar. Këto do të shqyrtohen më tej në pjesën vijuese mbi rrugën përpara.

5. QASJET E VENDEVE TË TJERA NË LIDHJE ME RIINTEGRIMIN E TË KTHYERVE NGA SIRIA DHE IRAKU

Ashtu si Kosova, edhe vende të tjera u përballën me sfidën se si të mbështesin riintegrimin efektiv të të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Për shembull, Danimarka e konsideron çështjen e të kthyerve, dhe veçanërisht ata që kanë marrë pjesë në luftime (luftëtarë të huaj/LH), një kërcënim kryesor për sigurinë. Kur LH-të kthehen në Danimarkë, ata kontrollohen nga policia dhe u jepet ndihma nga Shërbimi Danez i Sigurisë dhe Inteligjencës. Në vend që t'i kërcënojnë me burgosje dhe arrestim, autoritetet daneze kërkojnë të parandalojnë pjesëmarrjen në zonat e konfliktit duke siguruar programe të riintegritit dhe rehabilitimit që përfshijnë kujdesin shëndetësor, shkollimin dhe ndihmën në gjetjen e punës dhe strehimit, të referuara si Modeli Aarhus. Një qasje shtesë është përfshirja e prindërve dhe familjeve të tyre në një dialog me autoritetet lokale. Ata u ndihmojnë prindërve të merren me fëmijë të radikalizuar. Danimarka ka dy nisma strategjike: një Program të Parandalimit të Hershëm (PPH) për të parandaluar radikalizimin e mëtejshëm të atyre që nuk paraqesin një kërcënim të sigurisë, por që mund të paraqesin në ardhmen; e dyta është Programi Exit, i cili synon njerëzit e radikalizuar dhe përfshin trajtimin mjekësor për plagët e luftës dhe traumat psikologjike, si dhe ndihmë për gjetjen e punës ose rifillimin e arsimit. Arsimi shihet si një mjet i rëndësishëm dhe përfshin një "rrjet të lehtësuesve, mentorëve, trajnimeve gjithëpërfshirëse dhe punëtorive me instruktorë mbi procesin e deradikalizimit, risqet dhe risqet potenciale, si dhe menaxhimin e konflikteve" (CEP, n.d.). Këshilli komunal, policia dhe OJQ-të lokale bashkëpunojnë gjerësisht me komunitetet myslimane për ta parandaluar radikalizimin. Autoritetet u ndihmojnë familjeve të mbajnë kontakte me ata që janë ende në Siri, dhe gjithashtu u ndihmojnë t'i kthejnë të afërmit në shtëpi të afërmit përmes bisedave me zyrtarët qeveritarë, konsullatat dhe agjencitë e inteligjencës. Plani i Aarhus ka edhe një element të policimit në komunitet dhe dialogut me mësimdhënësit, këshilltarët dhe prindërit. Qasja nuk përqendrohet në ndryshimin e ideologjisë, por përqendrohet në sigurimin se nuk ndodh sjellja e kundërligjshme (po aty).

Në vendet e tjera të BE-së, si Belgjika, Gjermania dhe Holanda, duket se ka një theks në masat ndëshkuese në trajtimin e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Rik Coolsaet dhe

Thomas Renard kanë vërejtur se në Holandë të kthyerit vendosen në qendrat e paraburgimit të sigurisë së lartë, në Belgjikë ata mbahen në ‘kushte izolimi’ me qëllim që të parandalohet ndikimi i tyre tek të tjerët, ndërsa në Gjermani nuk ka ‘regjim të përcaktuar për të kthyerit’. (Coolsaet & Renard, 2018) Të tre vendet fokusohen në “trajktoret përshtatura të shkëputjes” (nga aspekti i sjelljes së dhunshme të ideologjisë së tyre ekstremiste) në vend të programeve të deradikalizimit (ndryshimi i mendimit dhe ideologjisë së tyre). Kjo do të thotë që të burgosurit trajtohen rregullisht me kujdestarët me një larmi ekspertize.” (po aty, para. 8). Kur të kthyerit e burgosur lirohen, të tre vendet kanë qasje të ndryshme si e mbështesin riintegrimin e tyre në shoqëri, siç shpjegohet nga Coolsaet dhe Renard:

“Është i disponueshëm shoqërimi i përshtatur për të ndihmuar procesin e tyre të ri-futjes. Vendimet merren nga autoritetet lokale dhe Shërbimi i Provës i Holandës. Për dallim, aranzhimet belge për periudhën pas paraburgimit mbeten tentative, por tani po profesionalizohen me shpejtësi. Ekziston një dallim i madh midis xhihadistëve të lëshuar në provë (programet e shkëputjes shpesh imponohen si kusht provues) dhe atyre që e refuzojnë regjimin e provës dhe vendosin të qëndrojnë në burg deri në fund të dënimit të tyre (duke refuzuar pjesëmarrjen në programet e shkëputjes ose këshillimit). Në Gjermani, si në Holandë, përpjekjet për riintegrim mbështeten nga sistemi i rregullt i provës, dhe vendimet merren mbi baza rast pas rasti.” (po aty, para. 9)

Jashtë Evropës, në rastin e Pakistanit fokusi është në ndihmën për të rindërtuar identitetet e luftëtarëve të huaj, duke u dhënë atyre kuptim dhe qëllim. Kjo përfshin sigurimin e mbështetjes psiko-sociale, pasi krijimi i lidhjeve është thelbësor për rindërtimin e identitetit. Objekti Sabaoon inkurajon të menduarit kritik, njohjen dhe vlerësimin e mendimeve të ndryshme, dhe “identifikimin e vlerave për të justifikuar vendimet e tyre si pjesë e diskursit intelektual.” Synimet janë të sigurohet drejtimi, kuptimi dhe qëllimi, si dhe mënyrat për t’u ndihmuar individëve të përfshihen në aktivitete më pozitive në vend që të kthehen në aktivitete kriminale. Ngulitja e një qëllimi më të lartë mund të ndihmojë në mbajtjen e individëve larg ekstremizmit të dhunshëm. Aktivitetet pro-sociale mund të ndihmojnë edhe në riintegrimin e luftëtarëve të huaj, sepse ato ndihmojnë në ndërtimin e një ure mes individëve dhe komuniteteve të tyre për të hequr stigmën e të qenit LH. Disa aktivitete fokusohen në ofrimin e bamirësisë dhe kryerjen e akteve të altruizmit në nivel lokal, duke përfshirë bërjen e donacioneve, larjen e rrugëve, pagimin e shkollimit për të siguruar klasa bazë të shkrim-leximit, përdorimin e shkathtësive për të ndihmuar jetën e fqinjëve, duke përfshirë ndihmën me transportin dhe pjesëmarrjen në dasma. Drejtuesit e komunitetit mund të ndihmojnë

në lehtësimin e këtyre veprimeve dhe të ndihmojnë të tjerët në komunitet të kuptojnë përvojën e LH-ve, procesin e tyre të riintegrit, dhe të tregojnë si planifikojnë të kontribuojnë në komunitet. Ndërveprimi dhe monitorimi nga një rrjet i anëtarëve të familjes, të afërmeve, anëtarëve të komunitetit dhe të moshuarve mund të jenë të rëndësishme për të siguruar përparimin. Së fundmi, është thelbësore vendosja e besimit mes individëve dhe agjencive të zbatimit të ligjit. Nganjëherë ata i shtyjnë të kthyerit që shkruajnë një deklaratë rrëfimi për t'i ndihmuar të pajtohen me ato që kanë bërë, ndërkohë që shprehin një gatishmëri për të ndryshuar. Këto dorëzohen në mënyrë anonime dhe mund të përmbajnë informacione për të informuar zbatimin e ligjit për militantizmin e pranishëm në komunitete, në mënyrë që ata ta adresojnë. Në Indonezi qeveria duket se e mbështet aktivisht riintegrimin ekonomik të të kthyerve, në mënyrë që t'i bëjë njëkohësisht të qëndrueshëm financiarisht, si dhe t'u japë një qëllim të ri si ndërmarrës biznesi. Për shembull, në Indonezi: "Zakonisht, një zyrtar do të paraqitet në shtëpinë e një ish të burgosuri me 350-700 dollarë amerikanë në rupiah indoneziane, dhe do të ofrojë të blejë materiale për krijimin e një biznesi. I detë përfshijnë një makinë qepëse për ndryshimet e veshjeve, një tezgë me rrota për shitjen e ushqimit në rrugë, ose një frigorifer-frizer për ruajtjen e pijeve të ftohta dhe akullit. [...] Ndërkohë që strategjia ka qëllime të mira dhe ofertat vlerësohen, problemi është se në përgjithësi procesi është i nxituar dhe ka shumë pak përcjellje." (Sumpter, 2019, para 11-12)

Qeveria e Kosovës mund të përfitojë nga këto qasje, veçanërisht në integrimin e një elementi komunitar në mbështetjen e tyre për riintegrim, që do të thotë të angazhohen udhëheqësit e komunitetit dhe anëtarët e familjes në mënyrë më aktive dhe më të gjerë. DPRPR-ja në Ministrinë e Punëve të Brendshme tashmë ka zhvilluar një lidhje të mirë me familjarët e të kthyerve, andaj kjo mund të zhvillohet më tej për t'i dhënë një rol komunitetit edhe në sigurimin që të kthyerit ndihen të mirëpritur por edhe rilidhen me identitetin e tyre shoqëror dhe shkëputen nga ideologjia radikale fetare. Një ide konkrete në këtë drejtim është krijimi i grupeve mbështetëse për të kthyerit, ku ata takohen rregullisht. Kjo paraqet edhe një mundësi që qeveria të bashkëpunojë me shoqërinë civile në zbatimin e këtij lloji të politikave. Në krahasim me vendet e tjera në BE, në rastin e Kosovës, një faktor madhor kontribues për procesin e riintegrit në shoqëri të të kthyerve është padyshim stili i jetës me lidhje të ngushta të komunitetit dhe përkushtimi ndaj lidhjeve familjare. Dr. Florian Qehaja shprehet se "shumica e kosovarëve u përkasin 'komuniteteve vendase', dhe për këtë arsye këtu ka njohuri më sistematike rreth tyre krahasuar me shtetet anëtare të BE-së" (Qehaja, 2019). Me fjalë të tjera, në Kosovë, suksesi i riintegrit shoqëror të të kthyerve i besohet familjes dhe komunitetit.

6. SHËNIME PËRMBYLLËSE DHE RRUGA PËRPARA

Ky raport shqyrtoi si është marrë qeveria e Kosovës, si dhe aktorët joqeveritarë, me të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Raporti tregon se qeveria e Kosovës është e përkushtuar për riatdhesimin e qytetarëve të vet dhe ka krijuar programe dhe institucione të përkushtuara për të mbështetur riintegrimin e tyre shoqëror, si dhe rehabilitimin e të kthyerve të burgosur. Kosova përdor dy qasje të përgjithshme në trajtimin e të kthyerve: qasjet restorative-ndëshkuese dhe mbështetjen e riintegrit shoqëror. Qasjet ndëshkuese-restorative kanë të bëjnë me të kthyerit për të cilët konstatohet se kanë kryer veprën penale të pjesëmarrjes në një konflikt të huaj, në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Sistemi Korrektues i Kosovës, me ndihmën e qeverisë amerikane, ka zhvilluar programe të posaçme që synojnë të mbështesin rehabilitimin dhe shkëputjen e tyre nga besimet radikale fetare. Këto përfshijnë kurse të zhvillimit të shkathësive dhe trajnime të tjera. Qasja në këto programe u vu qëllimisht në dispozicion të gjithë të burgosurve, për të shmangur perceptimin se të kthyerit shiheshin parë ndryshe dhe stigmatizimin e tyre. Gjithashtu, personeli i SHKK-së mori trajnime për punën me të kthyerit. Masat e tjera për të adresuar besimet ideologjike të të kthyerve përfshinin edhe ligjëratat fetare të dështuara nga imamët kosovarë. Problemet e tjera me qasjet ndëshkuese-restorative përfshijnë pjesëmarrjen e ulët të të kthyerve në programe si dhe mungesën e një sistemi të përcjelljes dhe mbështetjes pas lirimit të tyre. Siç u shprehën zyrtarët nga SHKK-ja, 'ata nuk kanë asgjë të suksesshme për të treguar nga jeta e tyre' (Gashi S., 2019). Për më tepër, këta zyrtarë vërejnë se ndërkohë që programet kanë arritur që disa të kthyer të bëhen më social dhe të angazhohen, ka edhe të tjerë që qëndrojnë të përkushtuar ndaj besimeve të tyre radikale fetare

Në lidhje me mbështetjen e riintegrit shoqëror, qeveria dhe aktorët joqeveritarë janë të përfshirë në mënyrë aktive. Qeveria ka krijuar një divizion (DPRPR) në kuadër të Departamentit për Siguri Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të punuar posaçërisht për koordinimin e riintegrit të të kthyerve. Pas mbërritjes në Kosovë, të kthyerit janë mirëpritur nga punonjësit socialë dhe mjekët, janë vendosur në një qendër të përkohshme strehimi të qeverisë ku morën përkujdesje për një periudhë emergjence prej 72 orësh. Gjatë kësaj kohe u përgatitën dokumentet e tyre personale, ata morën trajtime mjekësore, përfshirë mbështetjen

e shëndetit mendor, dhe u përgatit një vlerësim i nevojave të tyre për zgjidhjen e tyre në komunitet. Qeveria e Kosovës ka caktuar psikologët që të sigurohet kujdes për shëndetin e tyre mendor, i cili përfshin vizitat në shtëpi. Shumica e të kthyerve kanë shfaqur, ndër të tjera, simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD), megjithëse ka mungesë të qartësisë në lidhje me metodologjinë e ndjekur për t'i përcaktuar këto simptoma. Qeveria lehtësoi procesin e riintegrit të fëmijëve në shkolla, duke përfshirë klasa speciale për ata fëmijë që duhej të arrinin nivelin e bashkëmoshatarëve sepse nuk kishin asnjë klasë shkollë. Janë përfshirë edhe zyrtarë qeveritarë si dhe aktorë joqeveritarë, duke mbështetur prindërit dhe familjet përmes trajnimeve, ndër të tjera. Fëmijët jetimë u mirëpritën nga familjarët e prindërve të tyre. Familjet në nevojë u mbështetën që të regjistroheshin në skemën e ndihmës sociale dhe të merrnin ndihmë mujore financiare, megjithëse ka ankesa nga disa të kthyer se nuk e kanë marrë një mbështetje të tillë. Riintegrimi shoqëror i mbështetur nga qeveria ka përfshirë edhe marrjen me qira të shtëpive për ato familje që kishin nevojë për strehim. Këto qasje flasin për një përkushtim të qeverisë së Kosovës për të parandaluar pjesëmarrjen në konfliktet e huaja përmes programeve të rehabilitimit dhe mbështetjes për riintegrim. Sidoqoftë, DPRPR-ja i mungojnë burimet dhe një politikë gjithëpërfshirëse për riintegrim, çka pengon përpjekjet dhe potencialin e tyre. Ndërkohë që qeveria ka treguar gatishmëri dhe përkushtim për të ndihmuar riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, shihen mangësi të rëndësishme. Së pari dhe më e rëndësishmja, çdo institucion qeveritar që u intervistua për këtë studim ka theksuar mungesën e koordinimit.

Ndërkohë që duhet të vlerësohet përkushtimi i qeverisë për të mbështetur në mënyrë aktive riintegrimin, ekzistojnë disa sfida me qasjet aktuale. Para së gjithash, moria e mekanizmave të qeverisë që janë të angazhuar në mbështetjen e riintegrit nuk janë të koordinuar në mënyrë efektive. Si rezultat, kjo ndikon jo vetëm në ofrimin e mbështetjes shumë të nevojshme për të kthyerit, por dobëson aftësinë e qeverisë për ta monitoruar situatën në mënyrë efektive. Në këtë kontekst, shqetësim të veçantë përbën mungesa e pjesëmarrjes dhe përfshirjes efektive dhe domethënëse të nivelit komunal në proces, megjithëse mekanizmat e referimit ishin një hap në drejtimin e duhur, por ato nuk përfshihen në mënyrë efektive në proces. Gjithashtu, qeveria duhet të mendojë për përfshirjen e politikave përgjegjëse ndaj gjinisë, të cilat mund të lehtësohen duke sjellë institucione të tjera, të tilla si Agjencia e Kosovës për Barazi Gjinore dhe OJQ të udhëhequra nga gratë, në procesin e mbështetjes së ri-integrit.

Një sfidë tjetër e rëndësishme ka të bëjë me kohezionin. Ndërkohë që qeveria ka krijuar një divizion të veçantë në kuadër të MPB-së, DPRPR-ja nuk zbaton një politikë të posaçme qeveritare

në lidhje me të kthyerit, siç bën Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) që zbaton Rregulloren e Qeverisë Nr. 08/2015 për riintegrimin të personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegritit. DPRPR-ja varet shumë nga qasja në burimet e DRPR-së. Krijimi i një rregulloreje të ngjashme për DPRPR-në do të përmirësonte në masë të madhe kohezionin e qeverisë në lidhje me riintegrimin e të kthyerve. Ndërkohë që qasja e komunitetit ndaj përpjekjeve për riintegrim është pjesë e qasjeve të DPRPR-së, ajo nuk është zhvilluar siç duhet. Organizatat e shoqërisë civile mund të bëhen një partner i rëndësishëm në këtë kontekst. Në rrugën drejt së ardhmes, qeveria e Kosovës duhet t'i rimendojë qasjet e veta për të mbështetur riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, si dhe të kuptojë se vlera e një angazhimi të tillë është thelbësore edhe për parandalimin e përgjithshëm të ekstremizmit të dhunshëm. Mangësitë e qeverisë mund të përkeqësojnë vuajtjet dhe ankesat e të kthyerve dhe të frymëzojnë narrativa të reja të padrejtësive shoqërore. Në këtë kuptim, qeveria duhet të marrë parasysh nevojën për një veprimtari vetëdijesimi të bazuar në komunitet për të siguruar që nuk ka elemente stigmatizimi, marginalizimi ose dehumanizimi kundrejt të kthyerve.

Nga këndvështrimi i politikës, qeveria duhet:

- 1) Të kryejë një shqyrtim gjithëpërfshirës të politikave dhe institucioneve që koordinojnë dhe zbatojnë aktivitete që synojnë mbështetjen e riintegritit të të kthyerve nga zonat e luftës;
- 2) Të miratojë një koncept-dokument se si të riorganizohet mekanizmi ekzistues institucional që merret me deradikalizimin dhe riintegrimin, si dhe të krijohet një politikë koherente qeveritare mbi riintegrimin social dhe ekonomik të të kthyerve. Një dokument i tillë duhet të marrë në konsideratë edhe nëse vendosja e DPRPR-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme është opsioni më i përshtatshëm për detyrën që ka, duke marrë parasysh që MPMS-ja është bartëse kryesore e burimeve që do t'i duheshin DPRPR-së për të mbështetur riintegrimin shoqëror;
- 3) Të kryhet një shqyrtim i përpjekjeve të deradikalizimit të luftëtarëve të huaj që janë të burgosur në Shërbimin Korrektues të Kosovës, si dhe të shqyrtohet shkalla në të cilën ligjëratat nga imamët e sanksionuar të Komunitetit Islam kanë pasur ndonjë ndikim, dhe të modifikohet aranzhimi ekzistues;
- 4) Ministria e Punëve të Brendshme duhet të krijojë Grupin Këshillues të Shoqërisë Civile për Riintegrimin, në mënyrë që të përfshihet OJQ-të në përpjekjet e riintegritit përmes partneritetit me institucionet qeveritare.

PUNIMET E CITUARA

- Aliu, Y. (2019, October 7). Coordination of the technical team for PVE at the Ministry of Labour and Social Welfare. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Bajrami, L., & Semini, L. (2019, April 20). Gjetur në Associated Press: <https://apnews.com/2aeba44a350c44a7802cb31e9d83c86b>
- Bowcott, O., & Sabbagh, D. (2019, October 22). *News*. Gjetur në The Guardian: <https://www.theguardian.com/uk-news/2019/oct/22/shamima-begum-begins-appeal-against-loss-of-uk-citizenship>
- Bytyqi, K., & Mullins, S. (2019, August). *Volume 12, Issue 7*. Gjetur në Combating Terrorism Center – CTC at West Point: <https://ctc.usma.edu/returnee-foreign-fighters-syria-iraq-kosovan-experience/>
- CEP. (a.d.). *Denmark: Extremism & Counter-Extremism*. Gjetur në The Counter Extremism Project (CEP): <https://www.counterextremism.com/countries/Denmark>
- Coolsaet, R., & Renard, T. (2018, April 11). *Publications*. Gjetur në International Centre for Counter-Terrorism - The Hague: <https://icct.nl/publication/the-homecoming-of-foreign-fighters-in-the-netherlands-germany-and-belgium-policies-and-challenges/>
- European Commission. (2018, April 17). *Neighbourhood-enlargement*. Gjetur në Europa: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>
- Focus-Group-Gjilan. (2019, November 18). Reintegration of Returnees from Syria and Iraq. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Focus-Group-Kaçanik. (2019, December 10). Reintegration of the returnees from Syria and Iraq. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Focus-Group-Mitrovica. (2019, November 1). Reintegration of Returnees from Syria and Iraq. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Gashi, S. (2019, October 13). Executive Director of Partners Kosova. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Gashi, S. (2019, November 15). Officer of Kosovo Correctional Service. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Gërbovci, G. (2019, October 1). Division for Prevention and Reintegration of Radicalized Persons. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Government of Kosovo. (2015, September). Gjetur në Office of the Prime Minister: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_parandalim_-_ENG.pdf

- Government of Kosovo. (2017, September 17). Gjetur në Official Gazette: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15304>
- Hein, M. v., Felden, E., & Cani, B. (2019, February 10). *'Islamic State' returnees in Kosovo guided back into society*. Gjetur në DW: <https://www.dw.com/en/islamic-state-returnees-in-kosovo-guided-back-into-society/a-50668479>
- Holmer, G., & Shtuni, A. (2017, March). *Returning Foreign Fighters and the Reintegration Imperative*. Gjetur në United States Institute of Peace: <https://www.usip.org/sites/default/files/2017-03/sr402-returning-foreign-fighters-and-the-reintegration-imperative.pdf>
- Hyseni, M. (2019, October 24). Deputy leader of the Referral Mechanism in Gjilan. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Jaha, A. (2019, September 26). Coordinator of SPVERLT 2015-2020 in Ministry of Education. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Kika, A. (2017, October 26). *Kallxo*. Gjetur në Internews Kosova and BIRN: <https://kallxo.com/shkurt/gjilan-8-raste-te-individeve-te-radikalizuar/>
- Kosovo Assembly. (2015, March 12). Gjetur në Official Gazette of Republic of Kosovo: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10763>
- KRCT. (a.d.). *About Us*. Gjetur në Kosova Rehabilitation Centre for Torture Victims (KRCT) : <https://krct.org/aboutus/>
- Manisera, S. (2019, July 25). *After ISIS: how Kosovo is rehabilitating women and children repatriated from Syria*. Gjetur në The National: <https://www.thenational.ae/world/mena/after-isis-how-kosovo-is-rehabilitating-women-and-children-repatriated-from-syria-1.890533>
- Ministry of Internal Affairs . (2017). *Documents/Strategic documents*. Gjetur në Office of the Prime Minister: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/08/ANG-Strategjia-Shtet%C3%ABrore-per-Riintegrimin-e-Qendrueshem-te-PR-2018-2022....pdf>
- Ministry of Internal Affairs. (2018). *Documents*. Gjetur në Office of the Prime Minister: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/08/Strategjia-Nacionale-per-siguri-ne-Bashkesi-anglisht.pdf>
- Ministry of Internal Affairs. (2018, February). *Strategic Documents*. Gjetur në Ministry of Internal Affairs: <https://mpb.rks-gov.net/Documents/Strategjia%20Shtetore%20kunder%20Terrorizmit%20dhe%20Plani%20i%20Veprimit%202018-2023%20narrative.pdf>
- Ministry of Justice. (2018, May 11). *News*. Gjetur në <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,1857>
- Morina, A. (2019, November 11). Coordinator for implementation of SPVERLT 2015-2020 in Ministry of Healthcare. (S. Balaj, Intervistuesi)

- Municipality of Mitrovica South. (2019, July 15). *News*. Gjetur në Municipality of Mitrovica South: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicееjugut/news/komuna-e-mitrovices-pritet-te-behet-me-planin-komunal-per-parandalimin-e-ekstremizmit-te-dhunshem-ne-mesin-e-te-rinjve-2020-2022/>
- Naddaff, A. (2018, August 24). *WorldViews/Analysis*. Gjetur në Washington Post: <https://www.washingtonpost.com/world/2018/08/24/kosovo-home-many-isis-recruits-is-struggling-stamp-out-its-homegrown-terrorism-problem/>
- OSCE. (2018, August). Gjetur në Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE): <https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true>
- Perteshi, S. (2018, October 17). *Beyond the triggers: new threats of violent extremism in Kosovo*. Gjetur në Kosovo Center for Security Studies (KCSS): http://www.qkss.org/repository/docs/violent-extremism-eng_611603.pdf
- Perteshi, S. (2019, November). Reintegration of Returnees from war zones in Syria and Iraq. (S. Balaj, Intervistuesi)
- Qehaja, D. F. (2019, December 2). Community approaches to reintegration of returnees. (S. Balaj, Intervistuesi)
- RTK. (2019, December 6). *Aktuale*. Gjetur në RTK: <http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=396784>
- South Mitrovica. (2017, July 15). Gjetur në Municipality of South Mitrovica: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicееjugut/news/komuna-e-mitrovices-pritet-te-behet-me-planin-komunal-per-parandalimin-e-ekstremizmit-te-dhunshem-ne-mesin-e-te-rinjve-2020-2022/>
- Sumpter, C. (2019, February 19). *Publications*. Gjetur në International Centre for Counter-Terrorism - The Hague: <https://icct.nl/publication/reintegration-in-indonesia-extremists-start-ups-and-occasional-engagements/>
- Tahiri, A. (2019, April 20). *News*. Gjetur në Ministry of Justice: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,15,2000>
- UNDP. (2019). *International Civil Society Action Network (ICAN)*. Gjetur në United Nations Development Programme (UNDP): <https://www.undp.org/content/dam/oslo-centre/documents/undp-ogc-ICANReport-2019.pdf>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

327(496.51:569.1)

327(496.51:567)

Perteshi, Skënder

Zbërthimi i përgjigjes së Kosovës ndaj të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak / Skënder Perteshi, Shpat Balaj, Ramadan Ilazi. - Prishtinë : Qendra Kosovare per Studime te Sigurisë, 2020. – 44 f. ; 21 cm.

1.Balaj, Shpat 2. Ilazi, Ramadan

ISBN 978-9951-799-01-0

www.qkss.org

ISBN 978-9951-799-01-0



9 789951 799010